



Raporti Vjetor 2023

Përmbajtja

1.	Fjala e Kryetarit të Këshillit Drejtues.....	2
2.	Letër nga Drejtori i Përgjithshëm	3
3.	Vizioni-Misioni-Vlerat.....	4
4.	Prespektivat dhe planet për vitin 2024.....	5
5.	Sistemi Bankar Financiar në Shqipëri.....	6
6.	Informacion mbi Banken e Bashkuar të Shqipërisë.....	9
7.	Të dhënat financiare bazë të bankes.....	10
8.	Organet Drejtuese të Bankës.....	14
9.	Struktura Organizative.....	16
10.	Rrjeti i degëve.....	16
11.	Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe trainimet.....	17
12.	Manaxhimi i rrezikut.....	18
13.	Qeverisja korporative.....	28
14.	Përgjegjësia sociale.....	28
15.	Marketingu.....	30
16.	Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur me 2023.....	32

Fjala e Kryetarit të Këshillit Drejtues

Viti 2023 ishte një vit tepër i rëndësishëm për ecurinë e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë si pjesë e grupit financiar EUROSIG. Vizioni objektivat strategjike i Grupit për një bake aktive në tregun bankar dhe financiar të vendit kushtëzoi jo vetëm blerjen e aksioneve të bankës por edhe shtesën me të madhe të kapitalit të bere ndonjë herë në bankë.

Gjate vitit 2023, banka zgjeroi veprimtarinë e saj bankare dhe prezencën e saj ne territorin e vendit, forcoi dukshëm pozicionin e saj financiar, përmirësoi frytshmerinë dhe produktivitetin dhe e veprimtarive bankare. Banka është karakterizuar nga pozicioni i likuiditetit të mire duke përforcuar besimin e publikut të gjerë që dukshëm u vu re ne rritjen e depozitave të bankës.

Në emër të Këshillit Drejtues, dëshiroj të shpreh kënaqësinë për progresin dhe rezultatet e arritura. Gjatë vitit 2023, Këshilli Drejtues ka mbikëqyrur në mënyrë gjithëpërfshirëse zhvillimet e zgjerimit e veprimtarisë bankare brenda oreksit për risk të përcaktuar nga kë këshill, zhvillimet institucionale të bankës, projektet për digjitalizimin e bankës dhe kanalet alternative të shpërndarjes se produkteve bankare dhe zhvillimet e burimeve njerëzore.

Falënderoj grupin EUROSIG për mbështetjen e gjithanshme dhe jo vetëm financiare të bankës, anëtarët e Këshillit Drejtues, të Komiteteve në nivel Këshilli Drejtues, të drejtorisë dhe të komiteteve ekzekutive për pjesëmarrjen aktive dhe kontributin në progresin e arritur. Gjithashtu falënderoj gjithë drejtuesit e tjerë dhe gjithë punonjësit e bankës për angazhimin e tyre për arritjen e objektivave të veprimtarisë bankare e të zhvillimit institucionale të bankës.

Në emër të Këshillit Drejtues,

Jemin Gjana

Kryetar i Këshillit Drejtues

Letër nga Drejtori i Përgjithshëm

Të nderuar aksionarë, klientë, kolegë të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë,

Për Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, viti 2023 ishte vit i kthesës së madhe me një prezencë aktive në tregjet bankare dhe në tregun monetar vendas, me një pozicion financiar shumë të përmirësuar dhe premtues, me një mjaftueshmëri kapitali të dukshme dhe me një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm dhe mbështetës për veprimtarinë bankare e financiare të bankës.

Kjo falë përpjekjeve të punonjësve e të drejtuesve të bankës, por mbi të gjitha falë mbështetjes jo vetëm financiare, shumë të rëndësishme nga shoqëria mëmë "EUROSIG SHA" e cila në fund të vitit 2023, zotëroi 99,96% të kapitalit aksionar të paguar të bankës. Vetëm gjatë këtij viti, kapitali i bankës u shtua nga shoqëria mëmë me 2,44 miliard Lekë .

Veprimtaria bankare gjatë vitit 2023 është rritur në mënyrë të ndjeshme. Aktivitetet e bankës u shtuan me 4,42 miliard lekë dhe pjesa e bankës në treg u rrit me 22%. Ndërkohë, financimet dhe depozitat u shtuan me 42% dhe 19.84% respektivisht. Gjithashtu, numri i klientëve të bankës pati një rritje me 14.3%, që dëshmon për një besim të shtuar dhe të rritur. Banka morri vlerësime si nga publiku i gjerë i cili e konsideron si një bankë për shërbime financiare e bankare familjare dhe mirë-administruese e aktiveve të tij ashtu dhe nga bizneset që e konsiderojnë si një bankë e orientuar drejt nevojave të tyre të ndryshme e dinamike. Gjithashtu, rrjeti i bankës është vlerësuar ndërkombëtarisht për ofrimin e një ambienti i cili transmeton garanci dhe siguri, duke krijuar një ndjesi lidhjeje dhe bashkimi me klientët. Ky vlerësim erdhi në formën e një çmimi të akorduar nga Këshilli Gjerman i Dizajnit në Mynih për arkitekturë novatore të degës qendrore, arkitekture që po unifikohet edhe në degët e tjera të rrjetit.

Strategjia e bankës dhe aksionarit të saj për një bankë e orientuar nga individit dhe familjet ka dhënë frytet e para gjatë vitit 2023 jo vetëm me produkte e shërbime të prera sipas nevojave të tyre të ofruara nga rrjeti i degëve por edhe nga kanale të tjera alternative të shpërndarjes së produkteve e shërbimeve bankare si për shembull nëpërmjet Internet & Mobile Banking" kanale këto bashkëhore dhe tepër të përdorshme nga publiku sot e në të ardhmen.

Viti 2023 ka rezultuar i suksesshëm edhe në bashkëpunimin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë me biznesin. Banka ka mbështetur përmes financimeve zhvillimin e sipërmarrjeve dhe industrive të ndryshme në Shqipëri, ku financimet për sektorin e turizmit janë rritur me 53% dhe ato në pasuri të paluajtshme me 96%, krahasuar me vitin paraardhës.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time ndaj të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues si edhe Komiteteve në nivel Këshilli Drejtues për punën e tyre këmbëngulëse dhe udhëheqëse drejt vizionit dhe objektivave strategjikë të bankës.

Gjithashtu një mirënjohje e veçantë u kushtohet kolegëve të mi, punonjësve dhe drejtuesve të bankës, ndërkohe që mirënjohja më e thellë u kushtohet të gjithë klientëve për besimin e dhënë dhe partnerëve për bashkëpunimin shumë të ngushtë e të frytshëm.

Orfea Dhuci

Drejtor i Përgjithshëm

VIZIONI

Të Investojmë dhe kontribuojmë me një rrjet të gjerë bankar klasik dhe të zgjuar dhe një banke modulare në cloud:

- në plotësimin e nevojave për produkte e shërbime bankare e financiare të klientëve të bankës të gjithë komuniteteve brenda vendit
- në livrimin e një kthimi dhe pagesën e një dividendi koherent, të qëndrueshëm për aksionare

MISIONI

Kthim të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm për aksionarët dhe të jetë një qytetar i përgjegjshëm dhe i kujdesshëm i korporatës.

VLERAT

- Parimet Bankare Islamike
- Transparenca
- Përsosmëria
- Dinamika

PRESPEKTIVAT DHE PLANET PËR VITIN 2024

Për vitin 2024, Bank e Bashkuar e Shqipëri do të vijojë me zhvillimin e saj duke dhënë kontributin e saj në tregun financiar dhe bankar në Shqipëri.

Ecuria e ekonomisë shqiptare, zhvillimet e fundit në industrinë bankare, konkurrenca intensive dhe agresive në tregjet bankare, kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore, janë faktorë të cilët ndikojnë pozitivisht në ekzekutimin e Planit Operativ dhe parashikimet e rritjes së Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

Qëllimet dhe objektivat kryesore të planit operativ të Bankës paraqiten të përmbliohen si më poshtë:

- Zgjerimi i gamës dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të financimit islam.
- Rritja e numrit dhe cilësisë së klientëve të bankës dhe forcimi i marrëdhënieve bankë-klient.
- Përshtatja e strukturës organizative dhe përmirësimi i proceseve të biznesit për arritjen e objektivave të bankës.
- Arritja e rritjes së qëndrueshme të treguesve kryesorë të performancës së bankës dhe objektivave të depërtimit në treg.
- Krijimi i ndërgjegjësimit të publikut bankar islamik dhe promovimi i vlerave universale dhe zbatimi i përgjegjësisë shoqërore të korporatës së bashku me aleancën e palëve të interesuara për të ndërtuar reputacion dhe pranim në shoqërinë shqiptare.
- Përmirësimi cilësor në mbështetjen e biznesit të vogël, të mesëm e të madh
- Zgjerimi i veprimtarive bankare me pakicë nëpërmejt gjithë kanaleve të shpërndarjes së produkteve bankare.
- Zgjerimi i rrjetit të degëve dhe orjentimi nga aktivitetet bankare dixhitale në platforma bashkëkohore dhe të sigurt.
- Hapja e shpërndarjes omni-kanale të produkteve bankare dhe komunikimi me klientët.
- Përmirësime në sistemet e Teknologjisë së Informacionit.
- Forcimi i pozicionit financiar dhe i pozicionit të likuiditetit të bankes

SISTEMI BANKAR FINANCIAR NË SHQIPËRI

Në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë aktivitetin e tyre 11 banka të nivelit të dytë. Në fund të vitit 2023 bankat me kapital vendas zotëronin afërsisht 35% të aktiveve totale të sektorit bankar në vend. Rritja e peshës së bankave me kapital vendas në tregun bankar është njëkohësisht rezultat i procesit të shitblerjeve, por edhe i rritjes organike të përmasave të aktivitetit.

Viti i kaluar pritej të ishte përsëri delikat për sektorin bankar, sidomos për shkak të efekteve të mundshme të rritjes së normave të interesit dhe ngadalësimit të rritjes ekonomike. Por, efektet e këtyre zhvillimeve rezultuan të ishin shumë më të dobëta nga sa pritej.

Letrat me vlerë janë grupi më i madh i aktiveve në bilance. Totali i aktiveve të sektorit arriti vlerën e 1.97 trilionë lekëve, në rritje me 5.1% krahasuar me një vit më parë. Aktivitetet e sektorit u rritën me 5%, pavarësisht efektit të shtuar negativ statistikor nga zhvlerësimi i valutave të huaja në raport me monedhen Leke.

Letrat me vlerë përbëjnë 40% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, nga afërsisht 38% që zinin në fund të vitit 2022. Investimet në letra me vlerë përfshijnë kryesisht titujt e borxhit të qeverisë shqiptare dhe të emetuesve të huaj publikë dhe privatë.

Rritja e peshës së letrave me vlerë në bilance duket se ka ardhur kryesisht nga lëvizja e fondeve të bankave që mbaheshin në llogari dhe depozita në banka të tjera.

Rritja e yield-eve, veçanërisht në valutë të huaj, i nxiti bankat të zhvendosnin një pjesë të madhe të fondeve të tyre nga zëri i vendosjeve drejt investimit në letra me vlerë të borxhit.

Pesha e vendosjeve brenda bilancit zbriti në 8.5% të totalit të aktiveve, nga 10.2% që kishte qenë një vit më parë.

Kredia është zëri i dytë më i madh në bilancin e sektorit bankar është kredia, për një portofol total prej 718.6 miliardë lekësh, sa 36.5% e totalit të aktiveve.

Pesha e kredisë në bilanc ka rënë nga niveli prej 36.9% i vitit 2022, por në një masë të madhe, kjo ka ndodhur për shkak të efektit të kursit të këmbimit.

Kreditimi nga sektori bankar vijoi rritjen edhe për vitin 2023, por rritja u ngadalësua për të dytin vit radhazi.

Ngadalësimi i rritjes është ndikuar në një masë të madhe nga efekti i kursit të këmbimit. Në fund të vitit 2023, kursi i këmbimit Euro-Lek ishte në rënie me më shumë se 9% krahasuar me një vit më parë.

Kjo rënie ka dhënë efekt të qartë negativ mbi portofolin e kredisë në valutë të huaj, duke qenë se afërsisht gjysma e portofolit të kredisë së sektorit bankar është në valutë të huaj dhe kryesisht në Euro.

Të dhënat tregojnë se kreditimi e mbylli vitin e kaluar me ecuri befasuese dhe me një rritje përtej pritshmërive, në kushtet e një ekonomie në ngadalësim dhe normave më të larta të interesit.

Raporti i kredive me probleme në fund të vitit të kaluar zbriti në nivelin më të ulët të 15 viteve të fundit. Ky tregues në dhjetor ra në 4.7%, nga 5% që kishte qenë në fund të vitit 2022. Duke prekur nivelin më të ulët që prej tetorit të vitit 2008.

Zmadhimi i portofolit të kredisë ndihmoi gjithashtu në uljen e peshës specifike të portofolit të kredive me probleme.

Kursi i këmbimit luajti një rol të rëndësishëm në ruajtjen e aftësisë paguese të huamarrësve në valutë, por me të ardhura në Lekë. Në fund të vitit 2023, kursi i këmbimit Euro-Lek ishte në rënie vjetore me 9.1%, por në periudha të veçanta të vitit, rënia vjetore e kursit arriti deri në 14%.

Tregtia ngelet sektori më i kredituar, gjithashtu rriten pasuritë e paluajtshme.

Kredia e re për biznesin u rrit me 16% vitin e kaluar dhe arriti në 217 miliardë lekë. Të dhënat tregojnë që, mes sektorëve me peshë të konsiderueshme, rritjen më të lartë e shënuan aktivitetet e pasurive të paluajtshme, transporti dhe tregtia.

Tregtia mbetet dominuese në strukturën e kredisë për ekonominë, me pothuajse 37% të volumit total të disbursimeve të reja. Në vlerë, kredia e re për tregtinë në 2023 arriti në 80 miliardë lekë, në rritje me 27% krahasuar me vitin 2022.

Megjithëse kërkesa e brendshme ka shfaqur sinjale dobësie, edhe për shkak të rritjes së ndjeshme të çmimeve pas vitit 2022, shtimi i numrit të turistëve të huaj duket se e ka kompensuar pjesërisht këtë efekt.

Sektori i dytë më i kredituar i ekonomisë edhe vitin e kaluar ishte ndërtimi, me një vlerë kredie të re prej 39.6 miliardë lekësh, ose sa 18.2% e totalit. Kredia për ndërtimin megjithatë u rrit me ritme më të ngadalta, 6.7% më shumë krahasuar me vitin 2022.

Rritja e çmimeve të pronave në vitet e fundit ka nxitur edhe sistemin bankar të mbështesë investimet në këtë sektor, megjithëse një pjesë e portofolit mund të jetë e lidhur edhe me kredinë për firmat kontraktore të investimeve në infrastrukturë.

Sektori i tretë më i kredituar i ekonomisë ishte industria përpunuese, me 24.8 miliardë lekë, ose sa 11.4% e totalit. Kredia e re për industrinë përpunuese u rrit me 17% krahasuar me vitin 2022.

Rritje të lartë të kreditimit shënoi sektori i aktivitetit të pasurive të paluajtshme, me 164% krahasuar me vitin 2022 dhe ai i transportit dhe magazinimit, me 88% më shumë.

Një sektor që pësoi rënie të ndjeshme të kreditimit vitin e kaluar ishte energjia elektrike, me 32% më pak krahasuar me vitin 2022.

Sektori i bujqësisë, edhe vitin e kaluar, shënoi kreditim në vlera modeste, me 2.7 miliardë lekë në total, me një rritje prej 5.6% krahasuar me një vit më parë.

Kredia për shtëpi u rrit për të katërtin vit radhazi në 2023. Kredia e re për banesa u rrit me 5.2% krahasuar me vitin 2022.

Vlera e portofolit aktiv ose tepriçës së kredisë për shtëpi, në fund të vitit 2022, arriti në pothuajse 177.2 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 6.3%. Ritmet e rritjes janë ngadalësuar krahasuar me vitin 2022, por pjesërisht kjo i detyrohet efektit të kursit të këmbimit dhe zhvlerësimit të Euros ndaj Lekut.

Në total, ekspozimi i sektorit bankar në kredi për pasuri të paluajtshme arriti në 342 miliardë lekë, ose pothuajse 3.3 miliardë euro në fund të vitit të kaluar. Sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë, portofoli i kredisë për pasuri të paluajtshme u rrit me pothuajse 23% gjatë vitit 2023. Kjo shifër përfshin të dyja segmentet e klientëve, biznese dhe individë.

Depozitat në sektorin bankar shqiptar u rritën për të pestin vit radhazi në 2023, madje shkalla e rritjes u përmirësua krahasuar me vitin 2022.

Në fund të vitit të kaluar, vlera totale e depozitave arriti në 1.65 trilionë lekë, në rritje me 5.4% krahasuar me një vit më parë. Rritja e depozitave ishte pak më e lartë se niveli prej 4.9% i një viti më parë, pavarësisht efektit të fortë negativ të kursit të këmbimit mbi depozitat në valutë të huaj.

Rritet fitimi dhe kthimi nga kapitali. Rezultati i akumuluar neto financiar i sektorit bankar në fund të vitit 2023 shënoi fitim prej 27.3 miliardë. Qëndrueshmëria në rezultatin financiar të sektorit bankar është pasqyruar në qëndrueshmërinë e treguesve të përfitueshmërisë së sektorit bankar RoA dhe RoE, të cilët shënuan përkatësisht 2.08% dhe 21.21% nga 1.3% dhe 14.23% një vit më parë.

Dixhitalizimi. Një zhvillim shumë i rëndësishëm i vitit të kaluar ishte zhvendosja e mëtejshme e shërbimeve bankare drejt kanaleve dixhitale.

Ky është një tregues i modernizimit të tregut dhe i rritjes së shpejtësisë dhe komoditetit në marrjen e shërbimeve bankare për publikun.

Veprimet nëpërmjet kanaleve elektronike dominuan strukturën e transfertave bankare për vitin 2023.

Nga rreth 13.4 milionë transferta kreditimi të kryera nga klientët e sektorit bankar, më shumë se 57% e tyre, ose rreth 7.7 milionë veprime në total, u kryen në formë jo-letër.

Numri i llogarive në sektorin bankar u rrit për të tretin vit radhazi në 2023. Numri total i llogarive bankare në fund të vitit të kaluar arriti 3.24 milionë, me rritje 4.2% krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit të kaluar, numri i llogarive aktive në sektorin bankar është zgjeruar me afërsisht 127 mijë të tilla.

INFORMACION MBI BANKEN E BASHKUAR TË SHQIPËRISË

Banka e Bashkuar e Shqipërisë është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin Shqiptar. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike.

Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Proçedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licensën “Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Ligjin Nr. 8365, të datës 2 korrik 1998, “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë ushtron aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë bazuar në licencën Nr.03/1 akorduar nga Banka e Shqipërisë, duke ofuar shërbimet/produktet si vijon:

- Të gjitha format e financimeve, duke përfshirë edhe financimin konsumatore dhe financimin hipotekore; Qiranë financiare; Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, ceqet e udhetarit, ceqet bankare dhe kartat e pagesës;
- Ofrimin e garancive; Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutë, në një treg të vetorganizuar ose ndryshe si më poshtë:
 - i) Instrumente të tregut të parasë (ceqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj),
 - ii) Këmbim valutë,
 - iii) Instrumenta të këmbimeve valutë dhe instrumente për vlerësimin e normës së fitimit.
- Shërbimet këshilluese, ndërmjetës dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha vepimtaritë e listuara në pikat më sipër.

Historiku i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë ndër vite:

- 1993** Banka e filloi aktivitetin e saj në Shqipëri si një joint-venture ndërmjet Shtetit Shqiptar i përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregtare (BKT) një bankë shtetërore, ku Shteti Shqiptar zotonte 40% të kapitalit të Bankës dhe pjesa tjetër 60% zoterohej nga një grup investitorësh të huaj që përbehej nga institucione të rëndësishme bankare dhe individe.
- 1994** Viti i fillimit të veprimtarisë operacionale.
- 2000** Aksionet e zotëruara nga Shteti Shqiptar transferohen nga BKT tek Ministria e Financave (Drejtoria e Thesarit).
- 2009** Përfundon procesi i shitjes së 40% të aksioneve nga Ministria e Financave të aksioneri ekzistues, Banka Islamike për Zhvillim e cila tashmë bëhet dhe aksioneri kryesor i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë. Pas këtij transaksioni, Banka e Bashkuar e Shqipërisë bëhet një Shoqëri Tregtare me kapital tërësisht të huaj.
- 2012** Realizohet rritja e kapitalit të Bankës me mjete likuide gjë që rriti garancinë për një aktivitet të qëndrueshem dhe mundësinë për shtimin e produkteve bankare. Pas këtij ndryshimi në strukturën e kapitalit të bankës, aksioneri kryesor i Bankës, Banka Islamike për Zhvillim u bë mbajtësi i 86% të aksioneve të Bankës.

- 2019** Banka Islamike për Zhvillim shet 9% të aksioneve në favor të shoqërisë Eurosig SHA. Pas këtij transaksioni, Banka e Bashkuar e Shqipërisë bëhet një Shoqëri Tregtare me kapital të përbashkët (shqiptare - e huaj). Realizohet zmadhimi i kapitalit të bankes nga aksioneri Eurosig SH.A.
- 2020** Shoqërisë Eurosig SH.A blen aksione të tjera duke arritur përqindjen e aksioneve në 21.02%.
- 2021** Shoqërisë Eurosig SH.A bëhet dhe aksioneri kryesor i Bankës së Bashkuar të Shqipërisë duke arritur përqindjen e aksioneve në 51.02%.
- 2022** Aksioneri kryesor Eurosig SH.A realizon rritjen e kapitalit nëpërmjet fondeve likuide.
- 2023** Banka e Bashkuar e Shqipërisë bëhet një Shoqëri Tregtare me kapital shqiptarë me aksioner Eurosig SH.A. Banka Islamike për Zhvillim shet të gjitha aksionet e saj në favor të shoqërisë Eurosig SHA. Aksioneri Eurosig rrit kapitalit nëpërmjet fondeve likuide gjatë vitit 2023.

Aksionerët e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sipas 31 Dhjetor 2023 janë:

Struktura e kapitalit	31 dhjetor 2023
Eurosig sha	99.46%
Investitorë të tjerë - Arabia Saudite	0.54%

TË DHËNAT FINANCIARE BAZË TË BANKES

Gjatë vitit 2023 banka ka një rritje të treguesve financiarë baze të ndikuar nga veprimet me financimet ndaj klienteve dhe depozitave ndaj klienteve.


Sipas pasqyrës së pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, totali i aktiveve rezulton 16,994 milion lekë, në rritje me 35% nga viti 2022. Shuma e detyrimeve ndaj klientëve është rritur me +18 % duke arritur totalin 13,329 milion lekë. Rritje shënuan edhe Kapitalet e Veta duke arritur vlerën 4,669 milion lekë.

Ne '000 Leke	2019	2020	2021	2022	2023	'23 vs '22
Total Aktive	8,947,296	9,746,701	11,881,761	12,573,549	16,994,444	35%
Financime	5,500,594	5,904,902	7,146,388	7,861,826	11,890,590	51%
Depozita	7,444,893	8,492,204	10,131,996	11,249,002	13,329,621	18%
Kapital i Paguar	1,762,717	1,876,896	1,876,896	2,227,176	4,669,415	110%
RMK	16.1%	13.8%	13.1%	12.0%	19.8%	

Treguesit financiarë janë përllogaritur mbi bazën e pasqyrave financiare të Bankës, përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNFR").


Në vijim janë të shtjelluar zërat bazuar të shënimit shpjegues të pasqyrave financiarene seksionin "Pasqyrat Financiare".

Totali i aktiveve në fund të vitit 2023 ishte 16,994 milion Lekë (2022: 12,573 milion Lekë). Peshën më e madhe të aktiveve të bankës e ze zëri llogari të arkëtueshme financiare (kredidhënja). Në 2023 portofoli i kredidhënies për klientet përfaqësonte 70 përqind (2022: 63 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Arka dhe llogaritë në bankat përfaqësojnë rreth 23 përqind të totalit të aktiveve në 2023 (2022: 31 përqind).




Totali i huave dhe paradhënies për klientët në fund të vitit 2023 ishte 11,890 milion Lekë (2022: 7,861 milion Lekë). Sektori i biznesit zë vendin kryesor në këtë portofol dhe përbën 67 përqind të totalit të portofolit të kredisë për vitin 2023.

Përqendrimi i rrezikut sipas sektorëve ekonomikë brenda portofolit të borxhit nga financimet janë si më poshtë:




Totali i detyrimeve të Bankës për vitin 2023 ishte 13,976 milion Lekë (2022: 11,447 Leke). Në 2023, depozitat e klienteve përbëjnë rreth 95 përqind (2022:98 përqind) të totalit të detyrimeve të bankës dhe një burim të qëndrueshem financimi.



Banka ka një profil të qëndrueshëm kapitali me një Raport të Mjaftueshmërisë së Kapitalit prej 19.8 përqind, shumë më tepër se kërkesa minimale rregullatore prej 12 përqind. Më 31 dhjetor 2023, Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit ishte 19.81% (në 2022: 12.50%).

Kapitali aksionar i regjistruar është 4,669 milion lekë, i ndarë në 2,717,701 aksione me një vlerë nominale prej 1,718.15 lekë. Gjatë vitit 2023, aksioneri i Bankës, grupi Eurosig sh.a., injektoi një shumë shtesë kapitali prej 2,442 milion lekë. Islamic Development Bank Jeddah ka nënshkruar një marrëveshje shitjeje të aksioneve të saj në favor të Eurosig sh.a., me anë të së cilës kjo e fundit ka rritur pjesëmarrjen e saj në kapitalin aksionar të Bankës në 99.46% në 31 dhjetor 2023 nga 66.26% në 31 dhjetor 2022.



ORGANET DREJTUESE TË BANKËS

➤ Komitete në nivel Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues



Këshilli Drejtues siguron që Banka ka një sistem solid të qeverisjes dhe se aktiviteti i saj operacional zhvillohet në përputhje me rregulloret përkatëse në fuqi. Këshilli Drejtues zbaton politikat dhe strategjitë e bankës në përputhje me planin e biznesit, menaxhimin e riskut dhe të buxhetit vjetor.

Anëtarët e Këshillit Drejtues

Jemin Gjana	- Kryetar
Mateo Spaho	- Anëtar
Ilir Çekiri	- Anëtar
Orfea Dhuci	- Anëtar i përkohshëm

Komiteti i Kontrollit



Komiteti i Kontrollit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte, bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar, miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre, etj.

Anëtarët Komiteti të Kontrollit

Jemin Gjana	- Kryetar
Orjana Kalaja	- Anëtare

Komiteti i Riskut



Komiteti i Rrezikut këshillon Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues në lidhje me strategjinë dhe oreksin e përgjithshëm aktual dhe të ardhshëm të rrezikut, si edhe ndihmon Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues për të mbikëqyrur zbatimin e kësaj strategjie nga drejtuesit e lartë të bankës.

Anëtarët e Komiteti të Rreziku

Mateo Spaho	- Kryetar
Perseta Grabova	- Anëtare

Komiteti i Emërimeve dhe Shpërblimeve



Komiteti i Emërimeve dhe Shpërblimeve është përgjegjës për procesin e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të Drejtorëve dhe ka mbikëqyrje për shpërblimin në nivelet e korporatës dhe është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe procedurave të shpërblimit të dizajnuara për të siguruar një performancë efektive të Politikës së Shpërblimit.

Anëtarët e Komiteti i Emërimeve dhe Shpërblimeve

Jemin Gjana - Kryetar
Rexhina Belalla - Anëtare


➤ Komitetet në nivel ekzekutiv



Komitetet në nivel ekzekutiv organizojnë dhe drejtojnë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës; përcaktojnë dhe delegojnë detyrat të personeli, si edhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara; ndërmerrin masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përputhshmëri të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

- Drejtoria
- Komitetet e Financimeve Individë
- Komiteti i Financimeve Biznes
- Komiteti i Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO)
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut të Financimit (Kredisë)
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut Operacional
- Komiteti i Trajtimit të Financimeve me Probleme (Remedial)
- Komiteti i Etikës dhe Disiplinës
- Komiteti i Prokurimeve
- Komiteti i Teknologjisë së Informacionit
- Komiteti i Rekrutimeve

STRUKTURA ORGANIZATIVE




(1,2) - Executive Director & Members of Management Board
(2) - Members of Management Board

RRJETI I DEGËVE

Banka e Bashkuar e Shqipërisë gjatë vitit 2023 ka operuar në katër qytete: Tiranë, Shkodër, Fier dhe Durrës me gjithësej gjashtë degë.

Gjatë vitit 2024 parashikohet hapja e dhjetë degëve të reja duke arritur në fund të vitit në totalin e gjashtëmbëdhjetë degëve. Hapja e degëve të reja të UBA do të fokusohet kryesisht në rajonin perëndimor të vendit që është rajoni më i zhvilluar ekonomik i vendit në krahasim me rajonet e tjera. Për shkak të pozicionit të favorshëm gjeografik, klimës së butë dhe përqendrimit të madh të popullsisë, në këtë rajon janë të zhvilluara të gjitha industritë e ekonomisë si: bujqësia, industria, transporti, tregtia, turizmi, etj.



Drjetoria dhe Dega Qendore Tiranë

Rruga "Dritan Hoxha", Nd.11, H.3
Tirane, Albania
Tel.: +355 4 454 8888

Agjencia Stadiumi Dinamo Tiranë

Rruga "Emin Duraku"
Tirane, Albania
Tel.: +355 4 454 8850

Agjencia Rozafa Tiranë

Rruga "Arkitekt Kasemi", Nd.92, H.6
Tirane, Albania
Tel.: +355 4 454 8855

Dega Shkoder

Rruga "Qemal Dracini", Nd.92, H.6
Shkoder, Albania
Tel.: +355 4 454 8880

Dega Fier

Rruga "Ramiz Aranitasi"
Fier, Albania
Tel.: +355 04 454 8870

Dega Durres

Rruga "Petraq Boshnjaku"
Durres, Albania
Tel.: +355 44 548860

MANAXHIMI I BURIMEVE NJEREZORE DHE TRAINIMET

Banka e Bashkuar e Shqipërisë i kushton një vëmendje të veçantë menaxhimit të kapitalit njerëzor dhe e konsideron thelbësor për suksesin e përgjithshëm të Bankës.

Ne jemi të vetedijshëm për rëndësinë që kanë punonjësit tanë dhe ndaj mbetemi të përkushtuar ndaj zhvillimit dhe mirëqenies së tyre.

Gjatë vitit 2023, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka realizuar suksesshëm 55 procese rekrutimi, duke tërhequr dhe punësuar talentet më të mira në treg. Rekrutimet tona janë bazuar në parimet e diversitetit dhe përfshirjes, për të siguruar një ambient pune të hapur dhe gjithëpërfshirës. Kemi rritur numrin e punonjësve me 21%, duke sjellë në ekip profesionistë të kualifikuar dhe të motivuar për të kontribuar në suksesin e bankës.

Në fund të vitit 2023, BBSH kishte 115 punonjes, nga të cilët 80 femra dhe 35 meshkuj, ndërkohë që shpërndarja e stafit ka qenë 60% në drejtori dhe 40% e tyre në rrjetin e degëve.

Investimi në zhvillimin profesional të punonjësve tanë ka qenë një prioritet kryesor. Gjatë vitit 2023 kemi organizuar mbi 2290 orë trajnimi, që kanë mbuluar një gamë të gjerë aftësish teknike dhe të buta. Kjo ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe përgatitjen e tyre për sfidat e ardhshme.

BBSH ka vazhduar të forcojë pozitën e saj si një punëdhënës i zgjedhur për shumë profesionistë në treg. Përmes fushatave të ndryshme të marketingut dhe aktiviteteve sociale, ne kemi promovuar kulturën tonë të punës dhe vlerat tona. Këto përpjekje kanë ndihmuar në rritjen e reputacionit tonë dhe në tërheqjen e talenteve të reja. Kjo përfshinte pjesëmarrjen në panairë të karrierës, fushata të marketingut të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe rritjen e pranisë sonë në mediat sociale dhe platformat e rekrutimit.

Si rezultat, Banka e Bashkuar e Shqipërisë është njohur si një punëdhënës tërheqës në sektorin bankar.

BBSH ka rishikuar pagat dhe përfitimet për të reflektuar performancën e lartë dhe për të siguruar që punonjësit tanë të ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur. Gjatë vitit 2023 përqindja mesatare e rritjes së pagës ka qenë 39% për rreth 50% të stafit të bankës.

MANAXHIMI I RREZIKUT

1. Rreziku i Financimit

Informacion Cilësor

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut të financimit i cili është rreziku i humbjes financiare nëse klienti, apo pala e instrumentit financiar, nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga detyrimi. Ky rrezik vjen kryesisht si rezultat i levrimit të financimeve apo transaksione të tjera me palë prej të cilave rrjedhin aktivitet financiar. Për qëllime raportimi të administrimit të financimit, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të financimit (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Administrimi i rrezikut të financimit

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë finale për manaxhimin e rrezikut të financimit. Departamenti I Riskut është përgjegjës për monitorimin e rrezikut të financimit së Bankës, ndërkohë që manaxhimi i rrezikut të financimit përfshin:

- Formulimi i politikave të levrimit të financimeve, mbulimi i përshtatshëm me kollateral, vlerësimi i financimit, shkallëzimi i riskut dhe raportimi, dokumentacioni dhe procedurat ligjore, dhe përputhshmërinë me kërkesat rregullative dhe statutores;
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve të financimit. Komiteti i Financimit ose Bordi Drejtues i Bankës ka në dorë kufizimet për sa i përket autorizimeve të ndryshme.
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të financimit. Komiteti i Financimit të Bankës vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të financimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, përpara se facilitetet të jenë të angazhuara ndaj klientëve. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces rishikimi.
- Të kufizojë ekspozimin ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe parapagimet) dhe sipas emetuesit, bandën e klasifikimit të financimeve dhe nivelin e financimit të institucionit financiar, likuiditetin e tregut dhe ndaj shteteve të ndryshme (për investimet). Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Financimit të Bankës.
- Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të financimit.
- Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikën dhe procedurat e Bankës për administrimin e rrezikut të financimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrolle ndaj njësive të biznesit dhe Njesisë të Administrimit të Rrezikut të Financimit.

Banka strukturon nivelet e riskut të financimit që ajo ndërmerr duke vendosur limite në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës, apo grupe huamarrësish, dhe për segmentet gjeografike dhe të industrisë. Kufijtë në nivelin e rrezikut të financimit nga produkti dhe të sektorit të industrisë janë miratuar rregullisht nga drejtimi. Rreziqet të tilla monitorohen mbi baza të përtëritshme dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor, apo më të shpeshtë. Rreziku i financimit për zërat jashtë bilancit përcaktohet si mundësia për mbajtjen e një humbje si rezultat i dështimit i një pale tjetër për një instrument financiar për të kryer në përputhje me kontratën.

Informacion Sasior

Duke filluar nga Mars 2015, përllogaritja e kërkeses për kapital të rrezikut të financimit bëhet sipas rregullores për "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", miratuar me vendim nr.8 date 31.07.2013 nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë, i amenduar.

Tabela me poshte detajon Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së financimit para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të financimit, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregullator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

Rreziku I financimit : Informacion per portofolin e financimit sipas metodes standarte , sipas klasave te ekspozimit ne baze te rregullores “ Per mjaftueshmerine e Kapitalit”				Ne '000 lek
	Ekspozimi original para faktoreve të konvertimit (neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjonet)	Ekspozimi neto pas efektit zëvendësues të teknikave të zbutjes së financimit	Vlera e ekspozimit	Shuma e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut
Klasat e ekspozimit				
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	2,496,077	0	2,496,077	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	861,471	0	861,471	420,340
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	7,281,643	2,345	7,279,298	9,157,799
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	2,378,259	49,444	2,328,815	1,990,666
CR SA - Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruar me kolateral pasuri të paluajtshme	1,644,775	16,349	1,628,426	830,419
CR SA - Ekspozime (kredi) me probleme	597,681	0	597,681	751,613
CR SA - Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	0	0	0	0
CR SA - Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK	0	0	0	0
CR SA - Zëra të tjerë	2,113,174	0	2,113,174	1,480,295
CR SA - Totali i ekspozimeve	17,373,081	68,139	17,304,942	14,631,132

- Teknikat e zbutjes** - Ne portofolin aktual te financimit nuk ka financime qe perfitojne nga teknikat e zbutjes se rrezikut.
- Titullizimi**- Banka nuk eshte e ekspozuar ndaj instrumentave qe trajtohen si Titullizim, si rrjedhim nuk perllogarit ekspozime te mundshme.
- Ekspozime ne instrumente te Kapitalit**- Banka nuk eshte e ekspozuar ndaj ketyre transaksioneve si rrjedhim nuk perllogarit ndonje rrezik te mundshem

Tabela me poshte jep shperndarjen e ekspozimeve dhe ekspozimeve te mundshme te Bankes sipas klasave te ekspozimeve dhe peshes se rrezikut, kjo e fundit bazuar ne vleresimin e ECAI-ve apo plotesimit te kushteve rregullatore per secilen klase ekspozimi.

Rreziku I financimit : Informacion per portofolin e financimit sipas metodes standarte , sipas klasave te ekspozimit ne baze te rregullores “ Per mjaftueshmerine e Kapitalit” (ne Million Leke)											Pesha e rrezikut
	Vleresimet nga	0%	10%	20%	35%	50%	75%	85%	100%	125%	150%
Klasat e ekspozimit											
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	ECAI	0									
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	n/a	0									
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	n/a										
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	Nuk ka; S&P			52		242			92		33
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	n/a								3,522		5,636
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	Nuk ka						1,381			610	
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	Nuk ka				268	265		206	92		
Ekspozime (financim) me probleme	Nuk ka								290		462
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	Nuk ka										
Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	n/a										
Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK	n/a										
Zëra të tjerë	Nuk ka			3					1,465		12

2. Rreziqet e Tregut - Informacion i përgjithshëm

Informacion cilesor

Banka merr përsipër ekspozime të rrezikut të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në : (a) monedha, (b) normat e fitimit dhe (c) produktet e të kapitalit të gjithë të cilat janë të ekspozuar ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi vendos limite në vlerën e rrezikut që mund të jenë të pranueshme. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Administrimi i rrezikut të tregut

Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut i është dhënë ALCO-s. Departamenti i Rrezikut të Bankës është përgjegjës për zhvillimin e politikave të detajuara të manaxhimit të rrezikut (subjekt ndaj rishikimit dhe aprovimit nga ALCO dhe Bordi i Drejtorëve) dhe për mbikëqyrjen ditore të implementimit të tyre. Banka është e ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshimeve në kurset e këmbimit në pozicionin financiar dhe flukseve të parave.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak të transaksioneve në monedhë të huaj. Duke qënë se Banka i prezanton pasqyrat e saj financiare të veçanta në Lek, pasqyrat e veçanta financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet e kursit të këmbimit ndërmjet Lek-ut dhe monedhave të tjera. ALCO vendos limitet e niveleve të ekspozimit për të dyja pozicionet; brenda ditës dhe gjatë natës “overnight”, të cilat monitorohen çdo ditë nga Thesari dhe Departamenti i Manaxhimit të Rrezikut.

Rreziku i valutes së huaj specifikon rrezikun e ndikimeve negative në rezultatet financiare të bankes dhe mjaftueshmerin e kapitalit të shkaktuar nga ndryshimet në kurset e këmbimit. Banka ka një nivel të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të valutes pasi ajo nuk hyn në pozicione të hapura valutore spekulative, dhe as nuk angazhohet në transaksione që rrjedhin prej tyre. Rreziku i valutes administrohet në përputhje me Politiken e Administrimit të Rrezikut të Valutes së Huaj dhe rregulloret e Bankes së Shqipërisë mbi administrimin e rrezikut të valutes së huaj. Banka monitoron vazhdimisht lëvizjet e kursit të këmbimit dhe tregjet e valutes së huaj dhe menaxhon pozicionet e saj valutore në bazë ditore. Teste stresi kryen rregullisht për të vlerësuar ndikimin e lëvizjeve të kursit të këmbimit të pozicionet e hapura valutore (OCP) në çdo valute.

Informacion Sasior

Duke filluar nga Mars 2015, perlllogaritja e kërkeses për kapital të rrezikut të tregut behet sipas rregullores “Per Raportin e Mjaftueshmerise se Kapitalit”, miratuar me vendim nr.8 date 31.07.2013 nga Keshilli Mbikqyres i Bankes se Shqiperise,i amenduar.

Mjaftueshmëria e kapitalit për rrezikun e tregut është llogaritur në bazë të Kapitulli VII të rregullores se Bankës së Shqipërisë " Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit" , pasi kushtet e mëposhtme nuk plotësohet për fundit e muajit Dhjetor 2021:

- a) Gjatë dy nëntëmuajorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivitetit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;
- b) Gjatë dy nëntëmuajorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut është llogaritur si shuma e rrezikut të Pozicionit (Rreziku I Përgjithshëm dhe Rreziku Specifik), rrezikut të Përqendrimit në librin e tregtueshëm, Rreziku i Shlyerjes dhe rrezikut të Kursit të Këmbimit. Llogaritjet janë bazuar në metodën standarte.

- Rreziku i kursit të këmbimit, perlllogaritet në rastin kur pozicioni total neto i hapur valutore është më e lartë se 2% të kapitalit rregullator. Për fundin e muajit Dhjetor 2021 , pozicioni total neto i hapur valutore është më e lartë se 2% të kapitalit rregullator, rrjedhimisht është perlllogaritur kërkesa për kapital për këto rrezik.

		Kodi i monedhës	Te gjitha pozicionet		Pozicionet neto		Pozicione me trajtim preferencial		Kërkesa për kapital (%)		Kërkesa për kapital	Ekspozimet e ponderuara me rrezik
MKR SA FX - Rreziku i kursit të këmbimit												
			Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje		
		010	020	030	040	050	060	070			090	100
10	Pozicionet totale në monedhë të huaj		282,493	4,870	282,493	4,870					22,599	282,493
20	Monedhat me korrelacion të fortë											
30	<i>Të gjitha monedhat</i>		282,493	4,870	282,493	4,870			8	8	22,599	
40	Ari								8	8	0	
90	Scenario matrix approach											
	Ndarja e pozicioneve sipas llojit të instrumentit											
100	<i>Instrumenta financiare</i>		282,493	4,870								
110	<i>Zëra jashtë bilancit</i>											
120	<i>Derivative</i>											
	Pozicionet në valuta të ndryshme											
130	<i>Euro</i>	EUR	151,409	0								
230	<i>Paundi Britanik</i>	GBP	0	4,870								
360	<i>Turkish Lira</i>	TRY	4									
380	<i>Dollar Amerikan</i>	USD	131,081	0								

3. Rreziku i Normës së Fitimit

Informacioni Cilësor

Rreziku i normës së fitimit specifikon rrezikun që lëvizjet në normat e fitimit të tregut do të ndikojnë negativisht vlerën ekonomike të bankës si dhe fitimet e saj nga fitimi dhe në fund dhe vetë kapitalin. Rreziku i normës së fitimit administrohet në përputhje me Politikën e Administrimit të Normës së Fitimit dhe udhëzuesin e Bankës së Shqipërisë mbi administrimin e rrezikut të normës së fitimit në librin bankar. Gjatë vitit 2022 normat e fitimit shfaqen një tendencë rritjeje graduale. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së fitimit matet nëpërmjet një analize të hendekut të maturimit. Testet e stresit kryen në baza vjetore nga Departamenti i Manaxhimit të Rrezikut për të matur dhe analizuar ndikimin e ndryshimeve të normave të fitimit në vlerën ekonomike dhe të ardhurat nga fitimet.

Informacioni Sasior

Banka vlerëson dhe raporton ndjeshmërinë e të gjithë pozicioneve në librin e bankës ndaj luhatshmërisë së normave të fitimit. Për të realizuar këtë vlerësim banka aplikon një skenar , i cili supozon një shock (shift 200 basis point) ndaj kurbës së kthimit, pra supozon një ndryshim të normave të fitimit prej 200 basis point, në të gjitha monedhat kryesore individualisht, dhe në monedhat të tjera mbi baza të agreguara. Efekti që rezulton në ekspozimin e librit të bankës krahasohet kundrejt kapitalit rregullator. Ky raport duhet të jetë nën 20% në mënyrë që banka të mos konsiderohet tepër e rrezikuar ndaj rrezikut të normave të fitimit.

Burimet/format e rrezikut të normës së fitimit përfshijnë:

- rrezikun e riçmimit;
- rrezikun e kurbës së kthimit;
- rrezikun bazë; dhe
- rrezikun e opsioneve.

Raporti për administrimin e rrezikut të normës së fitimit në librin të bankës mbulon të gjithë pozicionet e Librit të Bankës të ndjeshme ndaj normave të fitimit. Raporti fokusohet në monedhat kryesore (konsiderohen të tilla nëse përbëjnë mbi 5% të aktiveve totale): ALL, EUR, USD dhe të tjerët. Pozicionet janë të ndarë sipas llojit të produktit dhe llojit të normës (norme fikse kundrejt normës së ndryshueshme). Pozicionet shpërndahen në intervalet kohore përkatëse si më poshtë:

- Pozicionet me normë fikse janë caktuar në intervalin kohor sipas maturimit të tyre Pozicionet me normë të ndryshueshme janë caktuar sipas datës së ardhshme të rishikimit të normës së fitimit. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat, në pasiv të bilancit, shpërndahen sipas mënyrës së përcaktuar më poshtë:
 - në intervalin kohor “at sight” (menjëherë/pa afat) vendoset një përqindje fikse (25%) e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat; në intervalet kohore nga “deri në 1 muaj” në “4-5 vjet” vendosen në mënyrë proporcionale me numrin e muajve që përmban intervali, llogaritë e mbetura (75%) e atyre të përfshira në shkronjën “a” më sipër;
- Rezerva e detyrueshme në lekë pranë Bankës së Shqipërisë caktohen në zonën kohore “deri në 1 muaj”, ndërsa rezerva e detyrueshme në monedhë të huaj konsiderohet si pozicion jo i ndjeshëm ndaj rrezikut të normës së fitimit
- Financimet me probleme caktohen në intervalin kohor “2-3 vjet”

Raporti për administrimin e rrezikut të normës së fitimit në librin e bankës përlllogaritet me frekuence mujore nga Departamenti i Manaxhimit të Rrezikut ndërkohë që raportimi pranë Bankës së Shqipërisë performohet në baza tremujore.

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	
	IRRBB	Monedha	Shuma
		1	2
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 1	ALL	-169,283
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 2	USD	18,218
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 3	EURO	10,424
1.4.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha 4	GBP	0
2	NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPozIMIT		140,641
3	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		3,112,166
4	(NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPozIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		7.51%

4. Rreziku Operacional

Rrezik operacional është mundësia që Banka të pësojë humbje financiare si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, ose i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin dhe rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik. Politika e rrezikut operacional e bankës është në përputhje të plotë me rregulloret e Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut operacional, me Politikën dhe Proçedurën e Rrezikut Operacional, si dhe me Politikën për Parandalimin e Mashtrimit. Për të minimizuar rrezikun operacional dhe rrezikun e mashtrimit, të gjitha proceset dokumentohen me saktësi dhe u nënshtrohen mekanizmave efikase të kontrollit. Përshkrimet e punës janë të plota, detyrat janë të ndara në mënyrë strikte dhe është shmangur varësia nga individë kyç.

Çështjet e rrezikut operacional monitorohen nga Departamenti i Manaxhimit të Rrezikut, i cili ka për qëllim të përcaktojë politika për rreziqet që lidhen me njerëzit, rreziqet që lidhen me proceset, rreziqet që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe sistemet, rreziqet e jashtme dhe aspekte të tjera të rrezikut operacional.

Punonjësve u kërkohet që të raportojnë të gjitha ngjarjet që përfaqësojnë një humbje faktike apo të mundshme. Ngjarje të raportuara që përmbajnë rreziqet më të shtrira, dhe që konsiderohen si ngjarjet me më shumë gjasa për t'u përseritur, i nënshtrohen një analize të thellë nga Departamenti i Manaxhimit të Rrezikut dhe me pas komitetit të ALCOs, i cili me vone propozon masat e përshtatshme parandaluese.

Nje aspekt kyç i administrimit të rrezikut është kultura e rrezikut të institucionit, e cila u përçohet të gjithë punonjësve përmes trajnimeve sistematike. Rreziqet operative lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës dhe shqyrtohen nga të gjitha njësitë e biznesit. Objektivi i Bankës është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me kosto efektive, si edhe të shmangë proçedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontroleve për të adresuar rrezikun operacional i caktohet çdo njësie biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për manaxhimin e rrezikut operacional. Pajtimi me standardet e Bankës mbështetet nga një program kontrollësh periodike të ndërmarra nga Kontrolli i Brendshëm.

5. Rreziku i Likuiditetit

Informacion çilesor

Rreziku i likuiditetit afatshkurter specifikon rrezikun që banka nuk do të jetë më në gjendje të përmbushë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e saj aktuale dhe të ardhshme të pagesave. Prandaj, banka duhet të ruaje gjithmonë fonde të mjaftueshme likuiditeti për të përmbushur detyrimet e saj, madje edhe në periudhe stresi.

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë më në gjendje të shlyejë detyrimet e saj financiare në kohën e duhur. Banka është e ekspozuar në kërkesa ditore nga burimet e saj të disponueshme të parasë nga depozitat një ditore, llogaritë rrjedhëse, depozitat e maturuara, shtesat e financimeve, garancitë dhe kërkesa të tjera për shlyerje në para të instrumentave derivateve.

Për të përcaktuar fuqinë e likuiditetit të bankes përballë një shoku të mundshëm, banka kryen teste stresi të rregullta bazuar në skenare të përcaktuar si standard në nivel banke.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj.

Departamenti i Thesarit merr informacion nga njësitë e tjera për sa i përket rrezikut të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe rrjedhjeve të ardhshme të parave, që rezultojnë nga aktivitetet e ardhshme të projektuara. Në bazë të këtij informacioni, Departamenti i Thesarit mban një portofol me aktive afatshkurtra likuide, i përbërë kryesisht nga investime me afat të shkurtër, hua dhe paradhënie ndaj bankave të tjera, dhe facilitete të tjera ndërbankare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm likuiditeti të Bankës. Kërkesat e njërive të biznesit për likuiditet plotësohen nga Departamenti i Thesarit, i cili jep hua afat-shkurtra dhe afat-gjata për të mbuluar ndryshimet afat-shkurtra dhe për financimet afat-gjata. Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testohet në mënyrë të rregullt nga Departamenti Manaxhimit të Rrezikut.

Të gjitha politikat dhe procedurat janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga Bordi Drejtues dhe ALCO

Informacioni Sasior

Ne perputhje të plote me rregulloren e Bankes së Shqipërisë “Per administrimin e rrezikut të likuiditetit” Banka përllëgarit, monitoron dhe raporton me baza ditore raportin që shpreh nivelin e aktiveve likuide përkundëjt pasiveve afatshkurtra, të njohur ndryshe edhe si raporti i “Treguesve të Likuiditetit”. Referuar rregullores, si zera aktuale likuide dhe shumë likuide në përllëgaritjen janë konsideruar zera të aktivitetit si më poshtë :

- a. Arka;llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”;
- b. 80 (tetëdhjetë) për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”;
- c. tituj “të investimit” të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj;
- d. 80 (tetëdhjetë) për qind të titujve të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në shkronjat “c”, “d” dhe “e”, të kësaj dispozite, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë” dhe „Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”;
- e. llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare;
- f. depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë;
- g. hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë (përfshihet llogaria 157 “hua të pakthyerë në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”);

Te gjitha aktivet e mesiperme jane konsiduar te tilla duke qene se mbi to nuk ekziston ansje angazhim/marreveshje qe e detyron banken te mos i perdori ato lirisht dhe ne menyre te pavaruar sa here qe mund te lind nevoja per likuiditet.

Raporti bashkelidhur shpreh nje situatë shume te kenaqshme likuiditeti jo vetem ne monedhen kombetare por edhe per monedhat e huaja.

AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA						
Kodi		LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
(në mijë lekë)						
1	Arka	72,522	67,997	470,759	12,341	623,618
2	Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masen e lejuar te perdorimit te saj, te percaktuar me akt nenligjor te Bankes se Shqiperise	1,477,390	723	150,399	0	1,628,512
3	Letra me vlerë "të investimit" të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj					
4	80 për qind të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në kodin "3", "4" dhe "5", por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së SHqipërisë "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë" dhe "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes"					
5	Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare	38,650	50,720	180,079	6,290	275,739
6	Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë	0	0	0	0	0
7	Hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në shtatë ditë (përfshihet llogaria 157 "hua të pakthyerë në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare");	0	0	0	0	0
A	TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE	1,588,561	119,440	801,238	18,631	2,527,870
		-	-	-	-	0
B	TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT	2,430,100	506,960	2,880,715	23,711	5,841,486
C	TREGUESI I LIKUIDITETIT (në %)					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)					65.37%
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)					27.53%
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)					43.27%

QEVERISJA KORPORATIVE

Një qeverisje korporative efektive është thelbësore për funksionimin e duhur të sektorit bankar dhe të ekonomisë në tërësi. Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomi nëpërmjet ndërmjetësimit të fondeve të kursimeve të depozituesve dhe aktiviteteve që mbështesin ndërmarrjet, si edhe ndihmojnë në rritjen ekonomike. Siguria, qëndrueshmëria e bankave dhe mënyra në të cilën ata kryejnë biznesin e tyre janë të rëndësishme për stabilitetin financiar dhe mirëqënien ekonomike. Dobësitë në qeverisje për bankat që luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin financiar mund të rezultojnë në transmetimin e problemeve në të gjithë sektorin bankar dhe ekonominë në tërësi. Qeverisja e korporatave përcakton ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësi me të cilat veprimtaria dhe punët e një banke janë kryer nga bordi i saj dhe menaxhmenti i lartë, duke përfshirë se si ata:

- Përcaktojnë strategjinë dhe objektivat e bankës;
- Zgjedhin dhe mbikëqyrin personelin;
- Drejtojnë biznesin e bankës në baza ditore;
- Mbrojnë interesat e depozituesve, përmbushin detyrimet si aksioner, si edhe marrin parasysh interesat e palëve të interesuara;
- Harmonizojnë kulturën, aktivitetet dhe sjelljen e korporatës me dëshirën se banka do të veprojë në mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë, me integritet dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi; si dhe
- Vendosin funksionet e kontrollit.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Përgjegjësia Sociale është një pjesë e rëndësishme e angazhimit të bankës në ndihmë dhe kontribut për komunitetin dhe mjedisin. Implementimi me sukses i projekteve të cilat synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit, të rriturit e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore, ka ndikuar në një perceptim pozitiv të imazhit të bankës.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë synon të jetë pjesë e ndryshimit të mirëfilltë në shoqëri dhe të krijojë një impakt pozitiv në mjedisin dhe komunitetin ku operon, duke ofruar mbështetje përmes nismave konkrete dhe të qëndrueshme. Iniciativat e ndërmarrja ndër vite kanë patur një ndikim pozitiv në shoqëri duke u kthyer në traditë dhe realizuar vit pas viti. Banka e Bashkuar e Shqipërisë është gjithmonë pranë shoqërisë në momentet më të vështira të saj dhe jo vetëm, në mbështetje të të rinjve, studentëve, njerëzve të sportit dhe kulturës.

Bursa Masteri për studentët ekselentë të Universitetit Epoka

UBA Bank si pjesë e grupit Eurosig dorëzoi 5 çmime për studentët e vlerësuar më mirë nga trajnimi rreth industrisë së sigurimeve dhe menaxhimit të riskut. Në këtë ceremoni morën pjesë Presidenti i Grupit Eurosig-Insig & UBA Bank, Z. Kadri Morinaj, Drejtori i Përgjithshëm i UBA Bank, Z. Orfea Dhuci, Rektori i Universitetit Epoka, Prof. Dr. Ahmet Ostaz, Menaxhimi i Lartë i Grupit Eurosig-Insig & UBA Bank, si dhe pedagogë e studentë të Universitetit Epoka. UBA Bank ndihet krenare për të kontribuar në nxitjen e cilësisë në sistemin arsimor.

Festa e 1 Qershorit

Në Ditën e Fëmijëve Grupi Eurosig-Insig & UBA Bank bëri të lumtur mbi 300 fëmijë në qytetin e Librazhdit. Në këtë qytet u organizua një festë e madhe për të gjithë fëmijët, duke organizuar lojëra, duke shpërndarë dhurata dhe mjaft aktivitete të tjera. Një atmosferë festive që këta fëmijë do ta kujtojnë gjatë.

Stafi i UBA Bank dhuron gjak

Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe punonjësit e Bankës së Gjakut, u organizua dhurimi vullnetar i gjakut në ambientet e bankës. Mirënjohje për pjesëmarrjen masive të stafit duke dhënë në këtë mënyrë mesazhin për të përmbushur nevojat për gjak të njerëzve talasemikë dhe jo vetëm.

Dita e Solidaritetit dhe Aktivizmit Social në Shqipëri

Në kuadër të nismës “Dita e Solidaritetit dhe Aktivizmit Social në Shqipëri”, UBA Bank mirëpriti pranë zyrave, nxënës të Gjimnazit “Ismail Qemali”. Përmes nismës së Rrjetit AS@N në bashkëpunim me Rrjetin “Barazi në Vendimmarrje”, nxënësit patën mundësi të njihen me stafin e UBA BANK. Drejtori i Përgjithshëm i UBA Bank, Orfea Dhuci ndau me nxënësit eksperiencën e tij shumëvjeçare dhe perspektivën e zhvillimit të sektorit bankar në vitet e ardhshme. Në vijim të vizitës së tyre, ata u njohën me departamentet e ndryshme dhe drejtuesit respektiv duke krijuar një ide të përgjithshme mbi strukturat e bankës.

UBA Bank mbështet krijimin e klasës burimore në Shupenzë

UBA Bank ka mbështetur kauza të ndryshme me karakter social në shërbim të komunitetit, si komponent kryesor të përgjegjësisë sociale. Me ftesë të Partners Albania for Change and Development ju bashkuam me ankandit ‘Rrathë Dhurues’, ku kontribuam në krijimin e një klase burimore për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta në fshatin Shupenzë, Bulqizë. Nëpërmjet kësaj nisme komunitare synohet sigurimi i moduleve dhe materialeve të përshtatshme didaktike për tu ardhur në ndihmë mësuesëve me mjetet e duhura në një mjedis të përshtatshëm dhe për të lehtësuar procesin mësimor të fëmijëve.

Shpërndarja e dhuratave pëfëmijët e stafit të UBA Bank

Në një atmosferë festive të mbushur me energji dhe hare, shpërndamë dhuratat e festave të fundvitit. Babagyshi u përkujdes ti dorëzonte secilit prej fëmijëve të stafit të bankës një dhuratë të veçantë. UBA Bank ofroi kupon për secilin prej fëmijëve të stafit. Përpos shpërndarjes së dhuratave, fëmijët patën mundësinë të vizitonin degën qendrore dhe të shprehnin kreativitetin e tyre në krijimin e disa pikturave, të cilat na i dhuruan me shumë dëshirë.



MARKETINGU

Performanca në Rrjete Sociale

Rritja e aktivitetit në llogaritë e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë në rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram në vitin 2023 është e konsiderueshme dhe tregon për një trend të përdorimit dhe ndërveprimit në këto platforma. Në raport krahasimor me vitin 2022, vërehet një rritje interesi në audiencën e synuar prej 284% në Facebook dhe 174% në Instagram.

Digjital

Gjatë vitit 2023, Banka e Bashkuar e Shqipërisë intensifikoi përpjekjet në fushën e marketingut digjital për të përmirësuar ndërveprimin me klientët dhe për të rritur prezencën online. Duke përdorur kanale të ndryshme në mediat sociale, banka arriti të ofrojë një përvojë më të personalizuar për klientët e saj. Fushatat e marketingut digjital të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë gjatë 2023 jo vetëm që përmirësuan përvojën e klientëve, por edhe kontribuan në rritjen e njohjes të brandit dhe besueshmërisë së bankës në tregun financiar.

Lançimi i Platformës Digjitale “Internet & Mobile Banking”

Lançimi i platformës digjitale "Internet & Mobile Banking" në kanale të ndryshme komunikimi është një hapat më të rëndësishëm të ndërmarra gjatë vitit të kaluar. Ky proces shtrihet në një gamë të gjerë të kanaleve të komunikimit, duke përfshirë mediat sociale, faqet e internetit të bankës, postimet e bëra në rrjete sociale, reklamë në TV dhe në aktivizime out-of-home. Nëpërmjet përdorimit të kanaleve të ndryshme, sigurohet që mesazhi të arrijë audiencën e duhur në kohën e duhur, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përdorimit të platformës nga klientët.

Fushatat e Marketingut

Në vitin 2023, Banka e Bashkuar e Shqipërisë ndërmori një sërë fushatash të suksesshme për promovimin e depozitave dhe financimeve. Fushatat e dedikuara për depozita në monedha të ndryshme u fokusuan në ofrimin e normave më konkurruese të fitimit për klientët. Këto oferta përfshinin depozita me afat të gjatë dhe të shkurtër, duke u përshtatur me nevojat e ndryshme të klientëve dhe ofruar fleksibilitet në kohë prej 18 muaj deri në 5 vjet.

Edhe këtë vit, Banka e Bashkuar e Shqipërisë iu bashkua fushatës verore të Mastercard, e cila ofronte shpërblim për realizimin e më shumë se dhjetë blerjeve me kartë. Ndërsa për financimet, Banka e Bashkuar e Shqipërisë ofroi për klientët e saj produkte sipas parimeve më të mira të bankingut islamik. Financimi i shpejtë, konsumator dhe ai hipotekor ishin disa nga produktet e marketuara përgjatë vitit 2023. Fushatat e realizuara për secilin produkt kontribuan ndjeshëm në rritjen e bazës së klientëve.



UBA
United Bank of Albania

FINANCIM HIPOTEKOR

Përfito nga
Depozitat 2-vjeçare

5.5% në vit
Deri në 500.000 lekë

4% në vit
Deri në 5000 Euro

Kur pushimet verore kthehen në kujtimet e saj të preferuara nga fëmijëria:

priceless



Depozita 2-vjeçare Booster

3.9% /vit në Lek
3.7% /vit në Euro



Depozita 4x4 Off-Road

Përfito nga Depozita 4-vjeçare
Norma e fitimit **4%** në vit
Efitim i propozuar për 18 muaj



UBA

Fitim i lartë në pak kohë

Përfito nga Depozita 18 mujore në UBA Bank!

3.7% Norma e fitimit

LEK Shuma minimale
50,000



 **RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E
MBYLLUR ME 2023**

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

mazars

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	1
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	4
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	5
Pasqyra e flukseve monetare	6
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit	7
1. Informacion i përgjithshëm	8
2. Baza e përgatitjes	9
3. Parimi i Vijueshmërisë	11
4. Politika të rëndësishme kontabël	12
5. Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të reja dhe të rishikuara 34	
6. Administrim i rrezikut financiar	35
7. Analiza e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.....	62
8. Arka dhe mjete monetare të ngjashme.....	63
9. Të arkëtueshme financiare	64
10. Aktive të marra nga proceset ligjore	67
11. Aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	68
12. Aktive me të drejtë përdorimi.....	69
13. Aktive të tjera.....	70
14. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	70
15. Detyrime ndaj klientëve.....	70
16. Detyrime të tjera	71
17. Detyrimet për qira financiare dhe provizionet	72
18. Kapitali	73
19. Të ardhura nga operacione financiare	74
20. Të ardhura nga aktivitete të tjera financiare	74
21. Shpenzimet e lidhura me detyrimin ndaj klientëve	74
22. Të ardhura dhe shpenzime nga komisionet	75
23. (Humbja)/ Fitimi neto nga këmbimi valutë	75
24. Të ardhura të tjera	76
25. Shpenzimet e personelit.....	76
26. Shpenzime për zhvlerësimin nga humbjet e aktiveve financiare.....	76
27. Shpenzime për provigjone,neto.....	77
28. Shpenzime të tjera administrative	77
29. Tatimi mbi fitimin	78
30. Angazhime dhe Detyrime	79
31. Transaksionet me palët e lidhura	79
32. Ngjarje pas datës së raportimit.	80



Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe Aksionerët e Banka e Bashkuar e Shqipërisë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a** (Banka) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacione të tjera përfshijnë informacionin e përfshirë në raportin vjetor, të përgatitur nga drejtimi në përputhje me nenet 17 dhe 19 të ligjit 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit. Raporti vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti auditues. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë konkluzioni sigurie për to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur ai bëhet i disponueshëm dhe, duke e bërë këtë, të shqyrtojmë nëse informacionet e tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim. ose përndryshe duket të jetë i gabuar materialisht. Kur lexojmë Raportin Vjetor, nëse konkludojmë se në të ka një anomali materiale, neve na kërkohet t'ua komunikojmë këtë çështje personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë.

mazars

- Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Bankës, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

30 maj 2024

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

Diana Ylli (Golemi)



Auditues Ligjor


Pasqyra e Pozicionit Financiar

Shumat në '000 LEK

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktivët			
Arka dhe mjete monetare të ngjashme	8	2,895,661	3,122,841
Balanca të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	8	979,868	835,352
Të arkëtueshme financiare	9	11,890,590	7,861,826
Aktive të marra nga proceset gjyqësore	10	1,496	111,877
Aktive afatgjata materiale	11	173,919	226,921
Aktive me të drejtë përdorimi	12	299,790	15,502
Tatim fitimi i parapaguar	29	13,877	13,877
Aktive të tjera	13	739,243	385,353
Totali i aktiveve		16,994,444	12,573,549
Detyrimet			
Detyrime ndaj Bankave dhe Institucioneve Financiare	14	2,429,550	1,342,441
Huamarrje ndaj Bankave		145,028	-
Detyrime ndaj klientëve	15	10,900,071	9,906,562
Detyrime të qirasë financiare dhe provigjione të tjera	17	303,292	71,349
Detyrime të tjera	16	198,886	127,498
Totali i Detyrimeve		13,976,827	11,447,849
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	4,669,415	2,227,176
Rezervat	18	120,904	120,904
Humbje e mbartur		(1,772,702)	(1,222,380)
Totali i kapitalit		3,017,617	1,125,700
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		16,994,444	12,573,549

Pasqyrat financiare të Bankës u aprovuan nga Këshilli Drejtues me 26 maj 2024 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


 Orfeu Dhuci
 Drejtör i Përgjithshëm



 Florjan Bizhga
 Drejtör i Financës

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 8 deri në 80, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Shumat në '000 LEK

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor, 2022
Të ardhura nga operacionet bankare	19	693,276	547,679
Të ardhura nga operacionet bankare të tjera	20	36,550	20,450
Shpenzime për detyrim ndaj klientëve	21	(250,837)	(119,146)
Të ardhurat neto nga veprimet bankare		478,989	448,983
Të ardhura nga komisione dhe tarifa, neto	22	57,416	59,799
Humbja neto nga kursi i këmbimit	23	(197,119)	13,502
Të ardhura të tjera	24	(103,919)	29,020
Totali i të ardhurave (shpenzimeve) të tjera, neto		(243,622)	102,321
Zhvlerësimi i të arkëtueshme financiare, neto	26	(368,436)	(404,696)
Shpenzime provigjoni te aktiveve te marra nga proceset ligjore	10	1,496	(99,426)
Shpenzime te zhvlerësimeve dhe provigjoneve te tjera, neto	27	6,646	(32,109)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	11	(33,292)	(34,664)
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	12	(17,416)	(3,100)
Shpenzime personeli	25	(193,242)	(153,438)
Shpenzime për qiratë		(13,288)	(9,049)
Shpenzime të tjera administrative	28	(168,157)	(152,600)
Totali i shpenzimeve operative		(785,689)	(889,083)
(Humbja)/ Fitimi neto para tatimit		(550,322)	(337,779)
Tatim fitimi	29	-	-
(Humbja)/ Fitimi neto i vitit		(550,322)	(337,779)
Të ardhura të tjera përmbledhëse pas tatimit		-	-
(Humbje)/ Të ardhura të tjera përmbledhëse pas tatimit		(550,322)	(337,779)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 8 deri në 80 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyra e flukseve monetare

Shumat në '000 LEK

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim/(Humbja) përpara tatimit mbi të ardhurat		(550,322)	(337,779)
<i>Rregullimet per zerat jo-monetare:</i>			
Provigjone	9	361,789	(505,095)
Amortizimi i pronave, pajisjeve dhe makinerive	11	33,292	622
Zhvlerësimi i të drejtës së aktiveve të përdorura	12	17,416	9,385
Provigjonet e aktiveve të marra nga proceset ligjore	10	(1,496)	99,426
Zhvlerësimi i aktiveve të marra nga proceset ligjore	10	49,194	-
Të ardhura nga aktiviteti financues		(15,652)	154,683
Shpenzim interesi per detyrim ndaj klientit		23,451	(13,397)
		(82,328)	(592,155)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
Rritje në të arkëtueshmet financiare		(5,127,022)	(715,438)
(Ulje) / rritje në aktivet e tjera		(370,179)	(360,862)
(Ulje) / rritje në balancat me institucionet financiare		(144,516)	(85,820)
Rritje në llogaritë e klientëve		(98,094)	1,117,007
Ulje në detyrimet ndaj bankave		2,574,577	(120,760)
Rritje / (ulje) në detyrimet e tjera		24,562	(341,260)
Interes i arkëtuar nga aktiviteti financiar		745,477	547,679
Interes i paguar klienteve		(274,288)	(83,844)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		(2,669,483)	(43,299)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje të pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara	11	(29,484)	(14,919)
Shtesa ne aktivet e marra nga proceset ligjore	10	-	(68,371)
Shtesa ne te drejten e perdorimit te aktiveve	12	-	(4,453)
Aktivitet e shitura te marra nga proceset ligjore		111,876	(9,674)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		82,392	(97,417)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritje në kapitalin e aksioneve	18	2,442,239	350,280
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		2,442,239	350,280
Ulje neto në para dhe ekuivalentet e saj		(227,180)	(382,591)
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit		3,122,841	3,505,431
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit	8	2,895,661	3,122,840

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 8 deri në 80, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë Sh.a.*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimit të kapitalit***Shumat në '000 LEK*

	Kapitali Aksionar	Rezervat	Humbje te mbartura	Totali
Gjendje më 1 janar, 2022	1,876,896	120,904	(884,601)	1,113,199
Fitimi neto për vitin	-	-	(337,779)	(337,779)
Të ardhura përmbledhëse të tjera	-	-	-	-
Të ardhura totale përmbledhëse për vitin	-	-	(337,779)	(337,779)
Veprime me aksionarët të regjistruara direkt në kapital				
Injektimi i kapitalit	350,280	-	-	350,280
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,227,176	120,904	(1,222,380)	1,125,700
Humbja neto për vitin	-	-	(550,322)	(550,322)
Te ardhura përmbledhëse të tjera	-	-	-	-
Totali i humbjes totale përmbledhëse për vitin	-	-	(550,322)	(550,322)
Veprime me aksionarët të regjistruara direkt në kapital				
Injektimi i kapitalit	2,442,239	-	-	2,442,239
Gjendja më 31 dhjetor 2023	4,669,415	120,904	(1,772,702)	3,017,617

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet nga 8 deri në 80, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

(a) Njësia raportuese

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (referuar më poshtë si “Banka” ose “UBA”) është krijuar në Shqipëri për të zhvilluar veprimtari bankare në përputhje me legjislacionin shqiptar. Bazuar në nenet e Statutit të saj, Banka ndjek Parimet Sharia. Aktivitetet e Bankës përfshijnë veprimtarinë si administruese, mbi bazën e mirëbesimit, të fondeve të investuara në përputhje me parimet dhe ligjet Islamike. Banka është subjekt i Ligjit Nr. 9662 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”, të datës 18 dhjetor 2006 dhe nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Në 5 nëntor 1992, Banka mori aprovimin nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare. Proçedurat e regjistrimit përfunduan në 1 korrik 1994, data e themelimit. Në 11 janar 1999, në përputhje me Vendimin Nr.165, të datës 11 dhjetor 1998 të Bankës së Shqipërisë, Banka mori licensën “Për vazhdimin e aktivitetit bankar në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me Ligjin Nr. 8365, të datës 2 korrik 1998 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Veprimtaria kryesore e biznesit të bankës janë operacionet bankare tregtare brenda Republikës së Shqipërisë. Banka vepron nën një licensë të plotë bankare lëshuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Banka merr pjesë në skemën shtetërore të sigurimit të depozitave të administruara nga Agjensia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave.

Qendra e Bankës është vendosur në Tiranë. Aktualisht Banka ka një shpërndarje të aktivitetit në 6 degë në qytetet Tiranë, Shkodër, Fier dhe Durrës. Më 31 dhjetor 2022, Banka ka të punësuar 115 punonjës (2022: 95 punonjës). Zyra e regjistruar e Bankës është në rrugën Dritan Hoxha, ndërtesa nr. 11, Tiranë, Shqipëri. Numri unik identifikues është J91811004Q.

Më 31 dhjetor 2023, kompania mëmë e menjëhershme dhe përfundimtare e Bankës është Eurosig sh.a. duke rritur pjesëmarrjen e saj në 99.46% të aksioneve.

Struktura aksionare e regjistruar më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

EUROSIG SH.A	99.46%
Investitorë të tjerë	0.54%

Në 31 dhjetor 2023, Bordi i Drejtorëve dhe Komiteti i Auditimit të Bankës është i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

Bordi i Drejtoreve	Jemin Gjana	Kryetar
	Mateo Spaho	Anëtar
	Orfea Dhuci	Anëtar
	Ilir Çekiri	Anëtar
Komiteti i Auditimit të Bankës	Jemin Gjana	Kryetar
	Orjana Kalaja	Anëtar

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK').

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostove historike, me përjashtim të fondeve të investimit Mudaraba-Aktivitet e fondit të investimit, të cilat janë matur me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes.

(c) Monedha funksionale dhe prezantuese

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Monedhën Shqiptare ('LEK'), që është dhe monedha funksionale e Bankës. Përveçse kur tregohet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në LEK është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(d) Përmbledhje e vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që prekin aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën është kryer vlerësimi dhe në çdo periudhë të ardhshme që mund të prekë. Çështjet kryesore të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël, që kanë efekt domethënës mbi shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe që paraqiten në Shënimin 9 janë:

- Zbritjet për humbje nga kredia,
- Përcaktimi i vlerës se drejtë.
- Vazhdueshmëria
- Zhvlerësimet e aktiveve të marra nga proceset ligjore
- SICR
- Ndihma e klientit

Humbjet nga zhvlerësimi në aktive financiare – SNRF 9

Matja e humbjeve të zhvlerësimit sipas SNRF 9 në kategoritë e aktiveve financiare kërkon gjykim, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhjeve të ardhshme të parave dhe vlerave të kolateralit kur përcaktohen humbjet e zhvlerësimit dhe vlerësimi i një rritjeje të ndjeshme të rrezikut të kredisë. Këto vlerësime nxiten nga një numër faktorësh, ndryshime në të cilat mund të rezultojnë në nivele të ndryshme të korigjimeve.

Llogaritjet ECL të Bankës janë dalje të modeleve komplekse me një numër supozimesh në lidhje me zgjedhjen e inputeve të ndryshueshme dhe ndërvarësitë e tyre. Elementet e modeleve ECL që konsiderohen si gjykime të kontabilitetit dhe vlerësime përfshijnë:

- Modeli i brendshëm i vlerësimit të kreditit të Bankës, i cili i cakton PD- të në notat individuale
- Kriteret e Bankës për vlerësimin nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kreditit dhe kështu që korigjimet për asetet financiare duhet të maten në bazë të LTECL dhe vlerësimit cilësor
- Segmentimi i aktiveve financiare kur ECL e tyre vlerësohet mbi një bazë kolektive
- Zhvillimi i modeleve ECL, duke përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve
- Përcaktimi i lidhjeve midis skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, të tilla si nivelet e papunësisë dhe vlerat kolaterale dhe efekti mbi PD- të, EAD- të dhe LGD- të
- Përzgjedhja e skenarëve makroekonomikë dhe peshat e probabilitetit të tyre, për të nxjerrë inputet ekonomike në modelet ECL.

2 Baza e përgatitjes (vazhdim)

d) Përmbledhje e vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlera e drejtë e garancive

Banka mban kolateral kundër llogarive financiare në formën e interesave të hipotekës mbi pasurinë, sigurimet e tjera të regjistruara mbi pasuritë dhe garancitë. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes, dhe përditësohen në frekuencën e çdo viti dhe gjithashtu kur pasuria vlerësohet individualisht si e dëmtuar.

Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

a) Matje e pritshme e humbjeve të kreditit

Matja ECL. Matja e ECLs është një vlerësim domethënës që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe inputeve të të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes ECL janë të shpjeguara në Shënimin 4(d). Komponentët e mëposhtëm kanë një ndikim të madh në korigjimin e humbjes së kreditit:

- segmentimin e aktiveve financiare për qëllime vlerësimi ECL;
- përcaktimin e një niveli vlerësimi ECL mbi një bazë individuale instrumenti ose mbi baza kolektive;
- përkufizimin e falimentimit të aplikuar nga Banka;
- zhvillimin dhe aplikimin e modeleve të brendshme të vlerësimit të kredisë, të cilat caktojnë PD-të për notat individuale të rrezikut të kreditit;
- zhvillimin dhe aplikimin e modeleve të brendshme të përdorura për të vlerësuar ekspozimin e falimentimit ("EAD") për instrumentet financiare dhe angazhimet e kreditit;
- vlerësimin e humbjes së dhënë në falimentim ("LGD"), duke përfshirë gjykimet e bëra në vlerësimin e kolateralëve;
- kriteret për vlerësimin nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë;
- përzgjedhjen e skenarëve makroekonomikë dhe pesha e probabilitetit të tyre.

Banka rregullisht shqyrton dhe bën të vlefshme modelet dhe hyrjet në modelet për të reduktuar çdo dallim midis vlerësimeve të pritshme të humbjes së kredive dhe përvojës aktuale të humbjes së kredive. Për shkak të ndryshimeve të rëndësishme dhe të shpejta në mjedisin ekonomik, Banka vendosi të rregullojë metodën për të matur ECL për kreditë standarde, kreditë e specializuara dhe kreditë e lëshuara për SME-të. Menaxhmenti kreu një analizë lart-poshtë të portofolit dhe kishte identifikuar grupet e huamarrësve, për të cilat informacioni i mjaftueshëm dhe i mbështetur për matjen ECL është i disponueshëm vetëm në bazë të industrisë, në vend të bazës individuale. Studimet e aplikuar nga menaxhmenti rezultuan në rritjen e ECL për huamarrësit e korporatave në industrinë e mëposhtme:

- Rritja mesatare e ECL e prodhimit prej 53%
- Rritja mesatare e ECL e transportit prej 19%;
- Rritja mesatare e ECL me pakicë prej 31%;

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

d) Përmbledhje e vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredive ("SICR"). Me qëllim që të përcaktojë nëse ka patur një rritje të ndjeshme në rrezikun e kredisë, Banka krahason rrezikun e një falimentimi të ndodhur gjatë jetës së një instrumenti financiar në fund të datës së njoftimit me rrezikun e falimentimit në datën e njohjes fillestare. Vlerësimi konsideron rritjen relative të rrezikut të kredisë në vend që të arrijë një nivel specifik të rrezikut të kredisë në fund të periudhës raportuese. Banka i konsideron të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të mbështetura përpara në dispozicion pa kosto dhe përpjekje të tepërta, e cila përfshin një sërë faktorësh, duke përfshirë aspektet e sjelljes të portofoleve të veçanta të klientëve. Banka identifikon treguesit e sjelljes të rritjes së rrezikut të kreditit përpara delikuencës dhe inkorporoi informacionin e duhur përpara në vlerësimin e rrezikut të kreditit, ose në një instrument individual, ose në një nivel portofoli.

(e) Krahasuese

Shuma të caktuara krahasuese në deklarinimin e pozitës financiare, fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe rrjedhës së parasë janë riklasifikuar ose përfaqësuar si rezultat i një ndryshimi në klasifikimin për të reflektuar një efekt më të mirë.

3. Parimi i Vijueshmërisë

Drejtimi i ka përgatitur këto raporte financiare mbi bazën e parimit të vijueshmërisë. Për përgatitjen e tyre, drejtimi ka marrë në konsideratë pozicionin financiar të Bankës, synimet aktuale, përfitueshmerinë e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare dhe analizoi ndikimin e gjendjes së tregut financiar në operacionet e Bankës. Për sa i përket performancës financiare, Banka ka pësuar humbje të akumuluar në 3 vitet e fundit respektivisht 1,772,702,000 Lekë, 1,222,380,000, 832,966,000 në 31 Dhjetor 2023, 2022 dhe 2021. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në 31 Dhjetor 2023 dhe 2022 ishte 19.81% dhe 12.50% respektivisht ndërsa raporti minimal i kërkuar për bankat në Shqipëri është 12%. Menaxhmenti i Bankës ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të adresuar të gjitha pasiguritë e përshkruara më sipër. Si i tillë, gjatë vitit 2023, aksioneri i Bankës, grupi Eurosig sh.a., injektoi një shumë shtesë kapitali prej 2,442,239,050 Lekë, përkatësisht: më 30 qershor 2023: 533,138,269 Lekë; më 31 gusht 2023: 213,255,577 Lekë; dhe, më 29 dhjetor 2023: 1,695,845,204 lekë.

Islamic Development Bank Jeddah ka nënshkruar një marrëveshje shitjeje të aksioneve të saj në favor të Eurosig sh.a., me anë të së cilës kjo e fundit ka rritur pjesëmarrjen e saj në kapitalin aksionar të Bankës në 99.46% në 31 dhjetor 2023 nga 66.26% në 31 dhjetor 2022.

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të përcaktuara më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është thënë ndryshe.

(a) Transaksione të këmbimit valutor

Ekspozimi për rastet me vonesë bazohet në shumat që Banka pret që të jetë në borxhe në kohën e mospagimit, gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur. EAD-të 12-mujore dhe jetëgjatëse përcaktohen në bazë të profilit të pritshëm të pagesës, i cili ndryshon sipas llojit të produktit. Për produktet me amortizim dhe financimet me ripagim te plotë, kjo bazohet në ripagimet kontraktuale që i detyrohen huamarrësit gjatë një periudhe 12 mujore ose jetëgjatësi. Për të llogaritur EAD për një hua të Faza 1, Banka vlerëson ngjarjet e mundshme të mospagimit brenda 12 muajve për llogaritjen e 12mECL. Megjithatë, nëse një kredi Faza 1 që pritet të falimentojë në 12 muajt nga data e pasqyra e pozicionit financiarit dhe pritet gjithashtu të permiresohet dhe pastaj të rivendoset përsëri, atëherë merren parasysh të gjitha ngjarjet e paracaktuara të lidhura. Për aktivet financiare të Fazës 2, Fazës 3 dhe POCI, ekspozimi në mungesë konsiderohet për ngjarjet gjatë jetës së instrumenteve.

Banka përcakton EADs duke modeluar gamën e rezultateve të mundshme të ekspozimit në pika të ndryshme në kohë, që korrespondon me skenarët e shumëfishtë. SNRF 9 PD-të pastaj i caktohen secilit skenar ekonomik bazuar në rezultatin e modeleve të Bankës.

(vii) Humbja e caktuar nga mospagimi

Për portofolin e kredisë, vlerat LGD vlerësohen të paktën çdo tre muaj nga departamenti i rrezikut të specializuar të Bankës. Vlerësimi i rrezikut bazohet në një kornizë të standardizuar të vlerësimit LGD që rezulton me një normë të caktuar të LGD. Këto norma LGD marrin parasysh EAD të pritur në krahasim me shumën që pritet të mbulohet ose realizohet nga çdo kolateral i mbajtur. Banka e segmenton portofolin e saj në huadhënien e biznesit dhe individe, bazuar në karakteristikat kryesore që janë relevante për vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë. Banka vlerëson LGD-të rregullatore dhe SNRF 9 në një bazë të vetme. Sipas SNRF 9, normat e LGD vlerësohen për segmentin e Fazës 1, Fazës 2, Fazës 3 dhe POCI SNRF 9 të secilës klasë të aktiveve. Inputet për këto norma LGD vlerësohen dhe, aty ku është e mundur, kalibrohen përmes testimit të të kaluarave kundër rikuperimeve të fundit. Këto përsëriten për çdo skenar ekonomik sipas nevojës.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Vleresimi i zhvleresimit (vazhdim)

(viii) Rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë (vazhdim)

Banka vazhdimisht monitoron të gjitha asetet që i nënshtrohen ECL-ve. Për të përcaktuar nëse një instrument ose një portofol instrumentesh i nënshtrohet 12mECL ose LTECL, Banka vlerëson nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare. Banka konsideron një ekspozim që është rritur ndjeshëm në rrezikun e kredisë kur SNRF 9 PD per jetegjatesine është dyfishuar që nga njohja fillestare dhe është rritur me më shumë se 10 DPD. Banka aplikon gjithashtu një metodë të mesme cilësore për të nxitur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë për një aktiv, siç është lëvizja e një klienti / financimi në listën e vrojttimeve ose llogaria që bëhet për t'u siguruar. Në raste të caktuara, Banka mund të marrë në konsideratë gjithashtu që ngjarjet e shpjeguara në Shënimin 7.b janë një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë, në krahasim me një vonesë. Pavarësisht nga ndryshimi në shkallët e kredisë, nëse pagesat

kontraktuale janë më shumë se 10 ditë të kaluara, rreziku i kredisë konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Kur vlerëson ECL-të në baza kolektive për një grup aktivesh të ngjashme (siç përcaktohet në Shënimin 7), Banka zbaton të njëjtat parime për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare.

(ix) Grupimi i mjeteve financiare të matura në baza kolektive

Siç është shpjeguar në Shënimin 4.(d)(iv) varur nga faktorët më poshtë, Banka llogarit ECL-të ose në baza kolektive ose individuale. Klasa e mjeteve ku Banka llogarit ECL në baza individuale përfshijnë:

- Natyra specifike e financimit dhe kushtet e saj kontraktuale dhe financiare (maturimi, norma e referencës, etj.);
- Profili i ekspozimit deri në maturim në lidhje me lëvizjet potenciale të tregut;
- Ekzistenca e kolateralit ose garancive; dhe
- Potenciali për të mospaguar bazuar në vlerësimin e rrezikut të brendshëm.
- Thesari, tregtia dhe marrëdhëniet ndërbankare (të tilla si detyrimet nga bankat, kolaterali i parasë së gatshme për letrat me vlerë të huazuara dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar / FVOCI
- Ekspozimet që janë klasifikuar si POCI kur kredia origjinale është çregjistruar dhe një hua e re është njohur si rezultat i një ristrukturimi të borxhit të drejtuar nga kredia.

Klasat e aktiveve ku Banka llogarit ECL në baza kolektive përfshijnë:

- Balancat më të vogla dhe më të përgjithshme të kreditimit të biznesit të vogël të Bankës
- Faza 1 dhe 2 biznesi individë
- Ekspozimet e POCI të blera të menaxhuara në baza kolektive.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Vleresimi i zhvleresimit (vazhdim)

(ix) Grupimi i mjeteve financiare të matura në baza kolektive (vazhdim)

Banka e grupon këtë ekspozim në portofole më të vogla homogjene, bazuar në një kombinim të karakteristikave të brendshme dhe të jashtme të huave, si:

- Lloji i produktit (blerje për me qira / përdorim personal, overdraft, hua personale e pasiguruar, karta krediti etj.)
- Lloji i pronës (cilesi e larte, standarde, cilesi e ulët)
- Treguesit e vlerës së kredisë
- Vleresimi i brendshëm
- Vlera e ekspozimit
- Shfrytëzimi
- Industria e Huamarrësit
- Lloji i kolateralit

(x) Informacionet me vështrim nga e ardhmja

Vlerësimi i një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe llogaritja e humbjeve të pritura të kreditit, të dyja përfshijnë informacionin e ardhshëm. Banka ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variabla kryesorë ekonomike që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë për çdo portofol. Ndikimi i variablave ekonomike në probabilitetin e mospagimit, humbja e paracaktuar nga mospagimi dhe ekspozimi të mospagimi përcaktohet duke përdorur regresionin statistikor për të kuptuar ndryshimet e ndikimit në këto variabla kanë patur historikisht normat e mungesës dhe mbi komponentët e humbjes së caktuar nga mospagimi dhe ekspozimit të mospagimi.

Përveç skenarit ekonomik bazë, modeli siguron gjithashtu skenarin të mirë dhe më të keq dhe ponderimin sipas skenarëve për të siguruar që jolinearitetet janë kapur. Banka ka arritur në konkluzionin se tre skenare ose më pak kapin në mënyrë të përshtatshme jolinearitetin. Peshat e skenarit përcaktohen nga një kombinim i analizës statistikore, duke marrë parasysh gamën e rezultateve të mundshme që secili skenar i zgjedhur është përfaqësues. Banka vlerëson se këto parashikime përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të rezultateve të mundshme.

(xi) Analiza e karakteristikave të rrjedhës së parasë kontraktuale

Pasi Banka të përcaktojë se modeli i biznesit të një portofoli specifik është mbajtja e mjeteve financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale (ose duke mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe duke shitur aktivet financiare), ajo duhet të vlerësojë nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar rriten në datat specifike të flukseve të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për principalin e mbetur. Për këtë qëllim, interesi përcaktohet si një shumë për vlerën kohore të parasë dhe për rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot themelore të huadhënies, si dhe një marzh fitimi. Ky vlerësim do të kryhet në baza instrumentesh sipas instrumentit në datën e njohjes fillestare të aktivitetit financiar.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Vleresimi i zhvleresimit (vazhdim)

(xi) Analiza e karakteristikave të rrjedhës së parasë kontraktuale (vazhdim)

Kur vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Banka ka konsideruar kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Banka konsideron:

- Parapagimi, afati i zgjerimit
- Nëse kërkesa është e kufizuar në aktivet e specifikuara ose flukset e mjeteve monetare
- Instrumentet e lidhura me kontratë

(xii) Zhvlerësimi i përgjithshëm

Llogaritja e humbjeve të pritshme të kreditit kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël të cilat, sipas përkufizimit, rrallë do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale. Menaxhmenti ushtron gjykim në zbatimin e politikave kontabël të Bankës.

Instrumentet financiare në Fazën 1 kanë humbjen e pritshme të tyre të kreditit të matur në një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme të kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme të mundshme gjatë 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Fazat 2 ose 3 kanë humbjet e pritshme të kreditit të matura në bazë të humbjeve të pritura të kreditit në baza të jetës.

(xiii) Shpjegimi i inputeve, supozimeve dhe teknikave të vlerësimit

Humbja e pritshme e kredisë matet në bazë të një periudhe 12-mujore ose jetëgjatëse në varësi të faktit nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare ose nëse një aktiv konsiderohet për zhvleresim. Informacioni ekonomik i avancuar gjithashtu përfshihet në përcaktimin e PD-së 12-mujore dhe të jetës, EAD. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të klientëve të ndarë në Biznes dhe Individë. Humbjet e pritshme të kredisë janë produkti i skontuar i probabilitetit të mosplotësimit (PD) dhe ekspozimit me vonesë (EAD).

(xiv) Probabiliteti i mospagimit

Probabiliteti i mospagimit paraqet gjasat e një huamarrësi që nuk përmbush detyrimet financiare gjatë 12 muajve të ardhshëm ose gjatë jetës së mbetur të detyrimit. Si rregull, probabiliteti i mospagimit perjetë llogaritet duke përdorur probabilitetin 12 mujor të mospagimit, të zhveshur nga çdo diferencë e konservatorizmit, si një pikënisje. Pas kësaj, përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të zhvillohet profili i mospagimit nga pika e njohjes fillestare gjatë gjithë jetës së financimit ose portofolit të financimeve

Në rastet e kufizuara kur disa inputet nuk janë në dispozicion të grupimit të plotë, për llogaritjen përdoren mesataret dhe krahasimi i inputeve.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Vleresimi i zhvlerësimit (vazhdim)

(xv) Analiza e ndjeshmërisë

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në zbritjet e pritshme të humbjes së kredisë janë si më poshtë:
Portofolet e biznesit

- PBB-ja tremujore sipas metodës së prodhimit, rregulluar nga sezoni - Çmimet aktuale të PBB-së:
 - Industria
 - Shërbimet e Pasurive të patundshme
 - VSHB Vlera e Shtuar Bruto
 - PBB Produkti I Brendshëm Bruto
- PBB-ja tremujore sipas qasjes së shpenzimeve, çmimet konstante
 - Shpenzimet e Konsumit Final
 - Formimi i kapitalit fiks bruto
 - Absorbimi vendor
 - Eksporti Neto
 - Importi
 - Eksport
- Portfoli i individëve Tregu i Punës - Anketa e Forcave të Punës:
 - Shkalla e papunësisë
 - Pjesëmarrja në fuqinë punëtore
- Çmimet:
 - Indeksi i Cmimeve të Konsumatorit (CPI)
 - Indeksi i Cmimeve të Prodhimit (PPI)

Politikat e fshirjes

Banka fshin balancën e një aktivi dhe cdo fondi tjetër për humbjet nga zhvlerësimi të lidhur me të, kur departamenti i kredisë përcakton që aktivi nuk do të arkëtohet më. Ky përcaktim bëhet pasi merren në konsiderat informacione të rëndësishme, të tilla si ndryshimi domethënës i pozicionit financiar të huamarrësit / emetuesit, sipas të cilave huamarrësi / emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimin, apo që flukset nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për huatë me balancë më të vogël të standardizuar, vendimet e përgjithshme për fshirje janë bazuar në statusin e vonesës të produktit specifik.

Gjatë vitit 2023 Banka ka fshirë LEK 8,528,664 të ardhura të arkëtueshme (në 2022: 0).

Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë

Banka mban kolateral kundrejt të arkëtueshmeve financiare në formën e interesave hipotekare mbi pronën, letrat me vlerë të tjera të regjistruara mbi pasuritë dhe garancitë. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përditësohen me frekuencë tremujore dhe gjithashtu kur aktivi vlerësohet individualisht si i zhvlerësuar. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit të mbajtur kundrejt të arkëtueshmeve financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 është paraqitur më poshtë.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë (vazhdim)**

31 dhjetor 2023	Ekspozimi maksimal i rrezikut të kredisë	Prona të patundshme	Makineri, pajisje dhe inventar	Mjete monetare të bllokuara	Të tjera	Totali i kolateralit	Ekspozimi neto	ECLs përkatëse
Aktivët Financiare								
Balanca me Bankat	2,895,661	-	-	-	-	-	2,902,307	(6,647)
Balanca të kushtëzuara me Bankën Qendrore	979,868	-	-	-	-	-	979,868	-
Investimet me bankat dhe institucionet Financiare	-	-	-	-	-	-	-	-
Te arketueshme financiare	12,929,381	26,472,736	1,831,940	77,859	4,760,840	33,143,376	11,890,590	1,038,791
<i>Biznesi</i>	9,845,331	19,559,466	1,815,757	56,985	4,757,698	26,189,906	9,152,207	693,124
<i>Individe</i>	3,084,050	6,913,270	16,183	20,875	3,142	6,953,470	2,738,383	345,667
Pjesa e papërdorur e angazhimeve financiare	151,552	165,221	186	-	90,510	255,916	151,552	-
Garanci të dhëna klientëve	460,740	-	-	229,066	160,000	389,066	460,740	-
Total	17,417,202	26,637,957	1,832,126	306,925	5,011,350	33,788,358	16,385,057	1,032,144

6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**(b) Risku i kreditit (vazhdim)****Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë (Vazhdim)**

31 dhjetor 2022	Ekspozimi maksimal i rrezikut te kredisë	Prona të patundshme	Makineri, pajisje dhe inventar	Mjete monetare të bllokuara	Të tjera	Totali i kolateralit	Ekspozimi Neto	ECLs perkatëse
Aktivët Financiare								
Balanca me Bankat	3,122,841	-	-	-	-	-	3,116,194	6,646
Balanca të kushtëzuara me Bankën Qendrore	835,352	-	-	-	-	-	835,352	-
Investimet me bankat dhe institucionet Financiare	-	-	-	-	-	-	-	-
Mudaraba-Te arkëtueshme financiare	8,532,186	13,477,715	-	41,968	113,332	13,633,015	7,861,827	670,359
Te arketueshme financiare <i>Individë</i>	5,481,713 3,050,473	<i>8,834,132</i> <i>4,643,583</i>	-	<i>32,115</i> <i>9,853</i>	<i>113,331</i> -	<i>8,979,579</i> <i>4,653,436</i>	5,075,793 2,786,034	405,920 264,439
Pjesa e papërdorur e angazhimeve financiare	-	-	-	-	-	-	-	-
Garanci të dhëna klientëve	40,574	-	-	-	-	-	40,574	-
Total	12,530,952	13,477,715	-	41,968	113,332	13,633,015	11,853,947	677,005

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë (vazhdim)**

Kolaterali në përgjithësi nuk kërkohet për investimet me bankat dhe institucionet financiare, dhe asnjë kolateral i tillë nuk është mbajtur më 31 dhjetor 2023 ose 2022. Efekti financiar i kolateralit është paraqitur duke ndarë vlerën e kolateralit veçmas:

- (i) ato aktive ku vlera e kolateralit është e barabartë ose mbivendoset me vlerën kontabël të aktiveve (mbi-kolateralizuara), dhe
- (ii) ato aktive ku vlera e kolateralit është më e vogël se vlera kontabël e aktiveve (aktivet e nënkolateralizuara).

Tabelat tregojnë vlerat e variablave / supozimeve të rëndësishme ekonomike që përdoren në secilin nga skenarët ekonomikë për llogaritjet ECL:

31 Dhjetor, 2023	Biznes	Individë	Totali
Optimist(25%)	52,087	56,924	109,011
Bazë(50%)	167,018	131,104	298,122
Pesimist(25%)	474,019	157,640	631,659
Total	693,124	345,668	1,038,792

31 Dhjetor 2022	Biznes	Individë	Totali
Optimist(25%)	21,761	20,117	41,878
Bazë(50%)	358,084	206,637	564,722
Pesimist(25%)	33,222	30,538	63,760
Total	413,068	257,292	670,360

Vlera e kolateraleve për 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

2023	Aktive te mbi-kolateralizuara		Aktive të nën-kolateralizuara	
	Aktive		Aktive	
	Vlera Kontabel e aktivit	Vlera E drejte kolateralit	Vlera Kontabel e aktivit	Vlera E drejte kolateralit
Korporata	4,051,481	13,687,989	1,575,006	520,579
SME	2,174,354	8,886,072	420,956	35,840
Persona fizike	980,853	3,466,542	642,681	43,525
Individë	2,388,982	6,353,652	695,068	149,177
Total	9,595,670	32,394,255	3,333,711	749,121

Vlera e kolateraleve për 31 dhjetor 2022 është si më poshtë:

2022	Aktive te mbi-kolateralizuara		Aktive te nenkolateralizuara	
	Aktive		Aktive	
	Vlera Kontabel e aktivit	Vlera E drejte kollateralit	Vlera Kontabel e aktivit	Vlera E drejte kollateralit
Korporata	222,492	569,000	531,705	504,576
SME	1,976,192	4,640,322	1,718,808	1,450,107
Persona fizike	471,880	1,245,402	549,203	570,171
Individë	1,402,058	3,161,893	1,648,415	1,491,543
Total	4,072,622	9,616,617	4,448,131	4,016,398

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Kolaterali dhe përmirësime të tjera të kredisë (vazhdim)**

Detajet e aktiveve të marra nga Banka nëpërmjet marrjes në posedim të kolateralit të mbajtur si garanci kundrejt të arkëtueshmeve financiare janë paraqitur në Shënimin 10. Politika e Bankës është të ndjekë realizimin e kolateralit. Banka në përgjithësi nuk e përdor kolateralin jo të gatshëm për operacionet e veta

Banka monitoron përqendrimet e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe sipas vendndodhjes gjeografike. Një analizë e përqendrimeve të rrezikut të kredisë nga paraja dhe ekuivalentët e saj, investimet me bankat dhe institucionet financiare dhe shumat e kufizuara me Bankën Qendrore (së bashku si 'Paratë e gatshme dhe gjëndjet me bankat'), Detajet nga aktivitetet financuese në datën e raportimit janë paraqitur më poshtë:

	Arka dhe balancat me bankat				Të arkëtueshme financiare			
	31 dhjetor, 2023	Si % mbi totalin	31 dhjetor, 2022	Si % mbi totalin	31 dhjetor, 2023	Si % mbi totalin	31 dhjetor, 2022	Si % mbi totalin
Vlera kontabël	3,875,529		3,958,193		12,929,381		8,532,186	
Të përqendrura sipas sektorit								
Korporata	-	0%	-	0%	9,080,202	70%	5,477,279	61%
Qeveri	2,496,077	64%	1,863,150	28%	-	0%	-	0%
Institucione financiare	1,379,452	36%	2,095,043	72%	765,129	6%	4,433	0%
Për individët	-	0%	-	0%	3,084,050	24%	3,050,473	38%
Total	3,875,529	100%	3,958,193	100%	12,929,381	100%	8,532,186	100%
% e përqëndrimit për cdo zë	25%		32%		77%		68%	

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e rrezikut te perqendrimit**

Përqëndrimet sipas vendndodhjes për llogaritë me bankat dhe institucionet e tjera financiare maten bazuar në vendndodhjen e njësisë së Bankës që mban aktivin, që ka një lidhje të lartë me vendndodhjen e huamarrësit. Përqëndrimi i vendndodhjes për letrat me vlere matet bazuar në vendndodhjen e emetuesit të letrës me vlerë. Arka dhe balancat me bankat mbahen me bankën qendrore që ka graden B+ (2022: B+) dhe bankat dhe institucionet financiare bazuar ne klasifikimet e kompanise Standard & Poor's qe jane si me poshte vijon:

	Arka dhe balancat me bankat		Të arkëtueshme financiare	
	31 dhjetor, 2023	31 dhjetor, 2022	31 dhjetor, 2023	31 dhjetor, 2022
Klasifikimi A në BBB+	214,467	714,312	-	-
Klasifikimi BBB në B-	2,048,691	1,933,107	-	-
Pa klasifikim	8,885	66,389	12,929,381	8,532,186
	2,272,043	2,713,808	12,929,381	8,532,186
Arka (Shënimi 8)	623,618	712,031	-	-
Total	2,895,661	3,425,839	12,929,381	8,532,186

Paraja dhe balancat me bankat përfshijnë balancat e kufizuara me Bankën Qendrore dhe investimet me bankat dhe institucionet financiare. Përqëndrimi i rrezikut sipas sektorëve ekonomikë brenda portofolit të borxhit nga financimet janë si më poshtë:

<i>Në mijë Lekë</i>	31 dhjetor, 2023		31 dhjetor, 2022	
	Shuma	%	Shuma	%
Tregtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiake	1,769,950	13.69%	2,014,342	23.86%
Tregti me pakicë	3,084,050	23.85%	2,921,599	37.50%
Prodhimi dhe shperndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	1,107,722	8.57%	627,202	5.02%
Industria përpunuese	1,023,844	7.92%	378,859	4.60%
Ndërtimi	2,516,389	19.46%	1,350,395	17.18%
Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	107,312	0.83%	4,433	0.09%
Transporti, Magazinimi dhe Telekomunikacioni	54,577	0.42%	30,487	0.37%
Bujqësia dhe gjuetia	128,948	1.00%	96,285	1.64%
Kolektive, sociale dhe personale	15,706	0.12%	510	0.93%
Shëndetesi dhe punë sociale	112,006	0.87%	37,828	0.52%
Edukimi	9,260	0.07%	67,913	0.19%
Hotele dhe restorante	796,042	6.16%	604,933	4.01%
Të tjera	2,203,575	17.04%	397,399	4.08%
Totali i financimeve të arketueshme (përpara zhvlerësimit)	12,929,381	100%	8,532,186	100%

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e rrezikut të përqëndrimit (vazhdim)**

Te arketueshme financiare te detajuara sipas segmenteve te biznesit me 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë paraqitur në tabelat më poshtë:

	31 dhjetor 2023					
	Individe	Korporata	SME	Person fizik	Staf	Totali
Linje kredie	1,069	895,538	323,022	135,491	101	1,355,221
Financime						-
Afatshkurtër	1,326	227,521	17,117	5,005	-	250,969
Afatmesëm	221,896	619,496	494,663	76,830	4,951	1,417,836
Afatgjatë	2,778,612	3,923,498	1,776,159	1,422,348	117,326	10,017,943
Minus tarifën e aplikimit	(41,225)	(39,567)	(15,650)	(16,140)	(6)	(112,588)
Total	2,961,678	5,626,486	2,595,311	1,623,534	122,372	12,929,381

	31 dhjetor 2022					
	Individe	Korporata	SME	Person fizik	Staf	Totali
Linje kredie	3,856	-	-	-	-	3,856
Financime						
Afatshkurtër	10,010	601,632	1,062,727	55,427	140	1,729,937
Afatmesëm	204,885	42,434	1,133,464	44,837	13,927	1,439,547
Afatgjatë	2,732,927	105,179	1,545,487	930,859	124,148	5,438,601
Minus tarifën e aplikimit	(35,564)	(8,385)	(25,765)	(10,040)	-	(79,754)
Total	2,916,114	740,861	3,715,913	1,021,083	138,215	8,532,186

Analizat e zhvlerësimit

Analizat e zhvlerësimit për të arkëtueshmet financiare më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 dhe lëvizjet në humbjet nga zhvlerësimi janë paraqitur në Shënimin 10. Norma e fitimit për financimet varion nga 2.0% në 15.47% në vit për valutë dhe nga 1.50% në 17.30% në vit në LEK (31 Dhjetor 2022: nga 2.3% në 13.00% në vit në valutë dhe nga 2.50% në 17% në vit në LEK). Lëvizjet në provizionet për detyrimet nga financimet e detajuara sipas segmenteve të biznesit për 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

	31 dhjetor 2023					
	Individë	Korporata	SME	Person fizik	Staf	TOTAL
Shumat në fillim të vitit	261,956	10,802	288,975	106,142	2,483	670,358
Shpenzimet për zhvlerësim	205,296	222,467	151,907	61,217	9,215	650,102
Rimarrja nga zhvlerësimi	(132,845)	(71,332)	(24,276)	(52,777)	(436)	(281,666)
Shumat në fund të vitit	334,407	161,937	416,606	114,582	11,262	1,038,794

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)****Analiza e rrezikut të përqendrimit (vazhdim)****Analizat e zhvlerësimit (vazhdim)**

	31 dhjetor 2022					
	Individë	Korporata	SME	Person fizik	Staf	TOTAL
Shumat në fillim të vitit	116,223	3,569	131,551	20,025	3,756	275,124
Shpenzimet për zhvlerësim	152,058	7,507	170,077	86,234	(1,241)	414,635
Rimarrja nga zhvlerësimi	(6,235)	(274)	(12,653)	(117)	(32)	(19,401)
Shumat në fund të vitit	261,956	10,802	288,975	106,142	2,483	670,358

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka mund të ndesh vështirësi në përballimin e detyrimeve të saj financiare, që shlyhen me para ose aktive të tjera financiare.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Bankës për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit është të sigurohet, sa më shumë që të jetë e mundur, që do të ketë përherë likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme ose pa rrezikuar çënimin e emrit të saj.

Thesari merr informacion nga njësitë e tjera në lidhje me profilin e likuiditetit të aktiveve dhe pasiveve të tjera financiare dhe detajet e flukseve të ardhshme të parave që rezultojnë nga aktivitetet e ardhshme. Thesari mban balanca të një portofoli me aktive afatshkurtra likuide, të përbërë kryesisht nga bonot e thesarit likuide afatshkurta dhe vendosje me bankat dhe institucione të tjera financiare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të likuiditetit të Bankës.

Thesari monitoron në baza ditore përputhshmërinë me rregulloret dhe limitet rregullatore të vendosura nga banka e Shqipërisë. Të gjithë politikat dhe procedurat e likuiditetit janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga Komiteti i Aktiveve dhe Pasiveve të Bankës ('ALCO').

Banka mbështetet në depozitat nga klientët dhe bankat, dhe kontributet nga aksionarët e saj si burimi primar i sigurimit të fondeve. Ndërkohë që kontributet nga aksionarët nuk kanë një maturitet të caktuar, depozitat nga klientët dhe bankat përgjithësisht kanë maturitet të shkurtër dhe një pjesë e madhe e tyre janë të ripagueshme sipas kërkesës. Natyra afat-shkurtër e këtyre depozitave rrit rrezikun e likuiditetit të Bankës, dhe Banka aktivisht menaxhon këtë rrezik nëpërmjet mbajtjes së çmimit konkurrues dhe monitorimit konstant të tendencave të tregut. Më 31 dhjetor 2023, balancat më të mëdha të klientëve përfaqësojnë 32.50% të totalit të depozitave (në 2022: 23.52%).

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme tregon aktivet dhe detyrimet financiare të Bankes sipas maturitetit të mbetur në 31 dhjetor 2023 dhe 2022:

2023	Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Total
Aktivët						
Arka dhe llogaritë me bankat	3,875,529	-	-	-	-	3,875,529
Të arkëtueshme financiare	1,233,909	116,323	172,646	585,024	9,782,687	11,890,589
Total	5,109,438	116,323	172,646	585,024	9,782,687	15,766,118
Detyrime						
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	59,163	-	2,504	10	2,367,873	2,429,550
Huamarrje ndaj Bankave	145,027	-	-	-	-	145,027
Detyrime ndaj klientëve	4,025,234	655,440	716,451	1,351,009	4,151,937	10,900,071
Total	4,229,424	655,440	718,955	1,351,019	6,519,810	13,474,648
Pozicioni neto i likuiditetit	880,014	(539,117)	(546,309)	(765,995)	3,262,877	2,291,470
Pozicioni neto i likuiditetit i akumuluar	880,014	340,897	(205,410)	(971,406)	2,291,470	-

2022	Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Total
Aktivët						
Arka dhe llogaritë me bankat	3,958,192	-	-	-	-	3,958,192
Të arkëtueshme financiare	476,273	255,243	736,623	1,197,775	5,195,913	7,861,826
Total	4,434,466	255,243	736,623	1,197,775	5,195,913	11,820,018
Detyrime						
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	7,964	22,984	-	7,619	1,303,873	1,342,441
Huamarrje ndaj Bankave	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	3,461,070	709,430	635,923	1,785,620	3,314,519	9,906,562
Total	3,469,034	732,414	635,923	1,793,239	4,618,393	11,249,002
Pozicioni neto i likuiditetit	965,432	-477,172	100,700	-595,464	577,520	571,016
Pozicioni neto i likuiditetit i akumuluar	965,432	488,260	588,960	-6,504	571,016	-

*Arka dhe mjete monetare të ngjashme, investimet me bankat dhe institucionet financiare, llogaritë e kushtëzuara me Banken Qëndrore janë paraqitur së bashku me 'Arka dhe llogaritë me bankat'.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela e mëparshme paraqet rrjedhjet e skontuara të parasë prej instrumentave financiare të Bankës, mbi bazën e maturitetit kontraktual më të shpejtë të mundshëm. Rrjedhja e parasë, e pritshme prej Bankës. lidhur me këto instrumente ndryshon në mënyre domethënëse nga kjo analizë. Për shembull, llogaritë rrjedhëse të klientëve, pritët të mbajnë një gjendje të qëndrueshme ose rritëse. Tabela e mëposhtme paraqet detyrimet financiare të paskontuara sipas maturitetit të mbetur kontraktual , duke përfshirë angazhimet dhe garancite financiare të dhëna:

31 dhjetor 2023	Vlera Kontabël	Rrjedha e parasë nominale bruto				
		Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	2,429,550	59,163	-	2,504	10	2,367,873
Huamarrje ndaj Bankave	145,027	145,027				
Detyrime ndaj klienteve	10,900,071	4,025,234	655,440	716,451	1,351,009	4,151,937
Angazhime dhe garanci financiare	460,740	460,740				
Total	13,935,388	4,690,164	655,440	718,955	1,351,019	6,519,810

31 dhjetor 2022	Vlera Kontabël	Rrjedha e parasë nominale bruto				
		Deri ne 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	1,342,441	7,964	22,984	0	7,619	1,303,873
Huamarrje ndaj Bankave	-	-				
Detyrime ndaj klienteve	9,906,562	3,461,070	709,430	635,923	1,785,620	3,314,519
Angazhime dhe garanci financiare	40,574	40,574	-	-	-	-
Total	11,289,576	3,509,608	732,414	635,923	1,793,239	4,618,393

Për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit që rrjedh nga detyrimet financiare, Banka mban mjete likuide që përmbajnë mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare dhe investime për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid. Këto asete mund të përdoren lehtësisht për të përmbushur kërkesat e likuiditetit. Të gjitha depozitat në maturitet të mbetur të detyrimeve të kontraktuara janë në gjendje të paguhen në cdo kohë.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshon nga cmimet e tregut, si normat dhe kurset e kembimit do të ndikojnë te ardhurat e Bankes si dhe vlerat e instrumentave financiare të mbajtura. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të duhura, duke optimizuar kthimin nga rreziku.

Ekspozimet ndaj rrezikut të normave të tregut

Risku kryesor, për të cilin portofolet jotregtare janë të ekspozuara është rreziku i humbjes nga ndryshimet në rrjedhjen e parasë ose vlerat e drejta të instrumentave financiare për shkak të ndryshimit të normave të interesit. Banka tenton të zbusë riskun duke monitoruar datat e ricimit të aktiveve dhe pasiveve të saj. Gjithashtu, efekti aktual do të varet nga një numër i caktuar faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën ripagesat bëhen më herët ose më vonë se data kontraktuale dhe variacionet në ndjeshmëri brenda periudhave të ricimit dhe ndërmjet monedhave.

Analiza e ricimit të normave të interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ricimit të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës. Aktivët dhe detyrimet me normë të ndryshueshme janë raportuar në përputhje me datën e tyre të ardhshme të ndryshimit të normave të interesit. Aktivët dhe pasivet me normë fikse janë raportuar në përputhje me datën e ripagesës së skedulit të principalit (me e hershmja midis ricimit kontraktual dhe dates e maturimit).

6. Menaxhimi I riskut financiar (vazhdim)**d) Risku I tregut (vazhdim)****Analiza e riçimitit të normave të interesit (vazhdim)**

2023	Deri ne 1 muaj	1 – 3 muaj	3 - 6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Nuk gjenerojnë interes	Totali
Aktive							
Arka dhe llogaritë me bankat	631,655	-	-	-	-	3,243,874	3,875,529
Të arkëtueshme financiare	533,299	27,160	2,528,334	7,013,088	1,788,708	-	11,890,589
Total	1,164,954	27,160	2,528,334	7,013,088	1,788,708	3,243,874	15,766,118
Detyrimet							
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	7,782	-	2,503	-	2,367,873	51,392	2,429,550
Huamarrja ndaj Bankave	145,027	-	-	-	-	-	145,027
Detyrime ndaj klientëve	781,953	655,440	716,451	1,341,028	4,148,674	3,256,524	10,900,070
Total	934,762	655,440	718,954	1,341,028	6,516,547	3,307,916	13,474,647
Pozicioni neto	230,192	(628,280)	1,809,380	5,672,060	(4,727,839)	(64,042)	2,291,471
Pozicioni neto i akumuluar	230,192	(398,088)	1,411,292	7,083,352	2,355,513	2,291,471	-
2022							
2022	Deri në 1 muaj	1 – 3 muaj	3 - 6 muaj	Deri ne 1 vit	Mbi 1 vit	Nuk gjenerojnë interes	Totali
Aktive							
Arka dhe llogaritë me bankat	337,361	-	-	-	-	3,620,831	3,958,192
Të arkëtueshme financiare	476,273	255,243	736,623	1,197,775	5,195,913	-	7,861,826
Total	813,634	255,243	736,623	1,197,775	5,195,913	3,620,831	11,820,018
Detyrimet							
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	7,964	22,984	0	7,619	1,303,873	-	1,342,441
Huamarrje ndaj bankave	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	3,461,070	709,430	635,923	1,785,620	3,314,519	-	9,906,562
Total	3,469,034	732,414	635,923	1,793,239	4,618,393	0	11,249,002
Pozicioni neto	-2,655,400	-477,172	100,700	-595,464	577,520	3,620,831	571,016
Pozicioni neto i akumuluar	-2,655,400	-3,132,571	-3,031,872	-3,627,336	-3,049,815	571,016	-

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Administrimi i rrezikut të normës së interesit kundrejt limiteve, plotësohet edhe nga monitorimi i ndjeshmësisë së aktiveve dhe pasiveve financiare të Bankës, me skenarë të ndryshëm të normave të kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës për një rritje ose zbritje në normat e interesit, duke supozuar që nuk ka një lëvizje asimetrike në kurbat e normave të interesit dhe një pozicion financiar konstant, është si më poshtë:

2023	Skenarët deri në një vit		Skenarët mbi një vit	
	100 pikë	100 pikë	100 pikë	100 pikë
Efekti i Fitimit (humbjes) së Vlerësuar	70,834	(70,834)	23,555	(23,555)

2022	Skenarët deri në një vit		Skenarët mbi një vit	
	100 pikë	100 pikë	100 pikë	100 pikë
Efekti i Fitimit (humbjes) së Vlerësuar	(36,273)	36,273	(30,498)	30,498

Lëvizjet e normave të interesit prekin fitimet e mbajtura që lindin nga rritjet ose zbritjet në të ardhurat neto nga operacionet bankare dhe ndryshimet në vlerat e drejta të raportuara në fitim ose humbje. Ekuivalentet e mesatares së ponderuar të normave të tregut për aktivet dhe pasivet financiare kryesore janë si më poshtë:

	Mesatarja e ponderuar e normave të interes					
	(LEK)		(USD)		(EUR)	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022
<i>31 Dhjetor</i>						
Aktive						
Bankat dhe institucionet financiare	0.00%	2.76%	5.75%	1.69%	0.00%	2.00%
Të arkëtueshme financiare	7.53%	7.43%	7.30%	6.65%	7.21%	6.21%
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	8.42%	0.00%	0.00%	0.00%	0.48%	0.00%
Detyrime ndaj klientëve	3.16%	4.02%	1.29%	0.73%	0.95%	0.54%

Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e kurseve të këmbimit. Banka tenton të administrojë këtë rrezik duke mbyllur pozicionet e hapura ditore në monedhë të huaj dhe duke monitoruar limitet e pozicioneve të hapura. Tabela e mëposhtme përmbledh pozicionin neto të aktiveve dhe pasiveve në monedhë të huaj të Bankës, më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 prezantuar në mijë LEK dhe një analizë e ndjeshmërisë së fitimit të bankës si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit të Lekut në raport me monedhat kryesore për të cilat Banka ka ekspozime.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i tregut (vazhdim)*****Rreziku i këmbimit valutor (vazhdim)***

Rreziku i këmbimit valutor është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e kurseve të këmbimit. Banka tenton të administrojë këtë rrezik duke mbyllur pozicionet e hapura ditore në monedhë të huaj dhe duke monitoruar limitet e pozicioneve të hapura. Tabela e mëposhtme përmbledh pozicionin neto të aktiveve dhe pasiveve në monedhë të huaj të Bankës, më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 prezantuar në mijë LEK dhe një analizë e ndjeshmërisë së fitimit të bankës si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit të Lekut në raport me monedhat kryesore për të cilat Banka ka ekspozime.

31 dhjetor, 2023	LEK	USD	EUR	Të tjera	Total
Aktivitet					
Arka dhe llogaritë me bankat	1,629,322	706,520	1,520,844	18,843	3,875,529
Të arkëtueshme financiare	6,505,286	1,337,224	4,048,080	-	11,890,590
Total	8,134,608	2,043,744	5,568,924	18,843	15,766,119
Detyrimet					
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve Financiare	2,393,797	29,844	5,909	-	2,429,550
Huamarrje ndaj Bankave	145,027	-	-	-	145,027
Detyrime ndaj klientëve	5,131,755	573,662	5,170,943	23,711	10,900,071
Total	7,670,579	603,506	5,176,852	23,711	13,474,648
Pozicioni neto	464,029	1,440,238	392,072	(4,868)	2,291,471
Pozicioni neto i akumuluar	464,029	1,904,266	2,296,339	2,291,471	-

Për analizën e ndjeshmërisë kundrejt dy valutave, EUR dhe USD ju lutem referohuni më poshtë:

Analiza e ndjeshmërisë	Efekti i FCR	Efekti i FCR	Efekti i FCR
LEK - +/- 10%	+/- 144,024	+/-39,207	-/+ 487
LEK - +/- 5%	+/- 72,012	+/- 19,604	-/+ 243

31 dhjetor, 2022	LEK	USD	EUR	Të tjera	Total
Aktivitet					
Arka dhe llogaritë me bankat	1,047,268	1,375,265	1,512,595	23,064	3,958,192
Të arkëtueshme financiare	4,171,335	648,581	3,041,910	-	7,861,826
Total	5,218,603	2,023,846	4,554,505	23,064	11,820,018
Detyrimet					
Detyrime ndaj Bankave & Institucioneve	1,333,223	1,740	7,474	3	1,342,441
Huamarrje ndaj Bankave	-	-	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	4,911,405	641,391	4,330,977	22,789	9,906,562
Total	6,244,628	643,131	4,338,451	22,793	11,249,002
Pozicioni neto	-1,026,025	1,380,715	216,054	271	571,016
Pozicioni neto i akumuluar	-1,026,025	354,690	570,744	571,016	-

Analiza e ndjeshmërisë	Efekti i FCR	Efekti i FCR	Efekti i FCR
LEK - +/- 10%	+/- 138,071	+/-21,605	-/+ 27
LEK - +/- 5%	+/- 69,036	+/- 10,803	-/+ 14

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i tregut (vazhdim)****e) Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe pasiveve financiare, për të cilat nuk ka një cmim të vëzhgueshëm në tregut, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit sic përshkruhet në politikat kontabël 4.d.i.D. Vlera e drejtë e analizuar sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlera kontabël e aktiveve që nuk maten me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	2023			Totali
	Vlera e Drejtë	Vlera e Drejtë	Vlera e Drejtë	
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	
Arka dhe mjete monetare të ngjashme	3,875,529	-	-	3,875,529
Të arkëtueshme financiare	-	-	11,890,590	11,890,590
Detyrime ndaj klienteve	-	-	10,900,071	10,900,071

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës kundrejt një rritjeje ose uljeje është si më poshtë

	2022			Totali
	Vlera e Drejte	Vlera e Drejte	Vlera e Drejte	
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	
Arka dhe mjete monetare të ngjashme	3,122,841	-	-	3,122,841
Të arkëtueshme financiare	-	-	7,861,826	7,861,826
Detyrime ndaj klienteve	-	-	11,249,002	11,249,002

(e) Të arkëtueshme financiare

Të arkëtueshme financiare shprehen neto pas zhvlerësimit. Portofoli i Bankës ka një vlerë të drejtë të vlerësuar për afërsisht e barabartë me vlerën e tij kontabël me normat përkatëse ekuivalente të interesit, që për afrohen me normat e tregut. Një pjesë domethënëse e portofolit është subjekt i ricimit brenda një viti.

Arka dhe llogarite me bankat

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë llogaritë rrjedhëse në bankat e nivelit të dytë. Meqenëse këto gjëndje janë afatshkurtra dhe me norma të luhatshme vlera e tyre e drejtë konsiderohet të barazohet me vlerën e tyre kontabël.

Depozita dhe huamarrje

Depozitat me afat kanë një vlerë të drejtë të për afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër dhe normave bazë të interesit, të cilat i për afrojnë normat e tregut. Shumica e depozitave maturohet brenda një viti.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

f) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte ose indirekte që lindin nga nje shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e Bankës, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën, dhe nga faktorë të jashtëm të ndryshëm nga rreziku i kredisë, i tregut dhe i likuiditetit, dhe që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore, dhe standarde përgjithësisht të pranuar të sjelljes operative. Rreziqet operacionale lindin nga të gjitha operacionet e Bankës.

Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional, në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës, me kostot efektive dhe të shmangë procedurat e kontrollit që kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin. Zbatimi i kontrolleve për adresuar rrezikun operacional është mbështetur nga zhvillimi i një sërë standartesh për administrimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkesat ligjore dhe rregullatore
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave
- kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale të hasura, dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara
- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe veprimet rregulluese të propozuara
- zhvillimi i planeve të mundshme
- trainimi dhe zhvillimi profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlimi i rrezikut, duke përfshirë sigurimin në rastet kur ky është efektiv.

Përputhshmëria me standardet e brendshme mbështetet nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga Auditi i Brendshëm. Rezultatet e rishikimeve të bëra nga Auditi i Brendshëm diskutohen me drejtimin e njësisë së biznesit me të cilin ato lidhen, me përmbledhjet e dorëzuara në Komitetin e Auditit dhe drejtimi i lartë i Bankës.

g) Administrimi i kapitalit

Kapitali rregullator i bankës konsiston në elementët e mëposhtëm :

- Niveli 1 i kapitalit (kapitali bazë), i cili përfshin kapitalin aksionar, primin e aksioneve, rezervën e detyrueshme dhe rezerva të tjera, fitimin e mbartur nga vitet e mëparshme dhe interesat e pakicës pas zbritjeve për emrin e mirë, aktivet afatgjata jomateriale dhe humbjet e porealizuara nga shitja e investimeve.
- Kapital shtesë i nivelit 1, i cili përfshin instrumente të klasifikuar si kapital.
- Niveli 2 i kapitalit (kapitali shtesë), i cili përfshin detyrimet e borxhit, të quajtura borxh i varur.

Politika e Bankës është të mbajë një bazë të fortë kapitali, si dhe të mbajë investitorët, kreditorët dhe besimin e tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Njihet gjithashtu ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin e aksioneve si dhe Banka njihet nevojën për të ruajtur balancën midis kthimeve me të larta që mund të realizohen me më shumë borxh dhe avantazhet e sigurisë së ofruar nga një pozicion i fortë kapitali. Banka ka respektuar të gjitha kërkesat për kapital të imponuara nga jashtë.

6. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**g) Administrimi i kapitalit (vazhdim)*****Kapitali rregullator***

Qasja e rregullatorit kryesor për matjen e mjaftueshmërisë së kapitalit bazohet kryesisht në monitorimin e lidhjes ndërmjet kërkesës për burime kapitale me burimet kapitale në dispozicion. Rregullatori kryesor përcakton udhëzime individuale të kapitalit për secilën bankë dhe grup bankar, mbi kërkesën për burime minimale të kapitalit prej 12%. Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, ndër masa të tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori shqiptar, Banka e Shqipërisë (“BSH”), e cila përcakton kapitalin ligjor të kërkuar për të mbështetur biznesin. Rregullorja “Për mjaftueshmërinë e kapitalit” nxirret në zbatim të Ligjit për Bankat. Kapitali rregullator më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 ishte si më poshtë:

	31 dhjetor, 2023	31 dhjetor, 2022
Fondi total aksionar	3,126,518	1,159,832
Aktive të paprekshme të zbritshme	(14,352)	(16,305)
Kapitali rregullator	3,112,166	1,143,526

Shumat në tabelë përfaqësojnë balancat bazuar në kërkesat e Bankës së Shqipërisë, të cilat ndryshojnë nga ato të raportuara në përputhje me SNRF-të. Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë nuk janë finalizuar në kohën e plotësimit të këtyre pasqyrave financiare. Sidoqoftë, Drejtimi beson që aftësia e Bankës për të vazhduar aktivitetin nuk do të përkeqësohet.

Shperndarja e kapitalit

